

RAPORTI

I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK


Për Programin e studimit MSc Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare

Ofruar nga Universiteti “EPOKA”

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

PHD. Elvin Gjevori

PHD. Gert Guri




(Korrik/2018)

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit MSc Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Universiteti Epoka
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	VKM Nr. 908, datë 26.08.2009
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	Urdhër 338, datë 14.08.2012
5	Titulli i programit të studimit:	Master i shkencave në Shkenca politike dhe marrëdhënie ndërkombëtare
6	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike/ 4 semestra
8	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Anglisht
11	Programi ofrohet nga institucioni	Po
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	-
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	7
16	Numri i studenteve	18 studentë



HYRJE

Të dhëna për programin e studimit Msc në “Shkenca Politke dhe Marrdhenie Nderkombetare”

Universiteti “Epoka” filloi aktivitetin e tij ne vitin akademik 2007-2008, si nje shkolle e larte ndersa në vitin 2012, në përputhje me dispozitat ligjore, statusi i këtij institucioni ndryshoi nga “Shkollë e Lartë” në “Universitet”. Institucioni e bazon programin e tij mbi tre shtylla kryesore: edukim, kërkim dhe kontribut për shoqërinë. Universiteti është i riorganizuar në tre fakultete: Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë i cili përbëhet nga Departamenti i Arkitekturës, Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike dhe Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit; Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative i cili përbëhet nga Departamenti i Bankë-Financë, Departamenti i Biznesit dhe Departamenti i Ekonomiksit; Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale i cili përbëhet nga Departamenti i Drejtësisë, Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Qendra për Studime Europiane”.




Fig. 1. Struktura e Universitetit Epoka

Universiteti Epoka është organizuar në bazë të një ndërthurjeje institucionale ndërmjet organeve akademike dhe atyre administrative. Këshilli Mbikqyrës përfaqeson interesat e pronareve të univesitetit, ndërkohë që Bordi Administrativ është instanca e ngarkuar me zbatimin e funksioneve manaxheriale të mbarëvajtjes se universitetit. Bie në sy një rol i këtij të fundit jo vetëm në aprovimin e strategjive të zhvillimit të univesitetit (pas propozimeve nga ana e Senatit Akademik por edhe në

aprovimin e propozimeve persa i takon mbylljes apo hapjes se njësive të reja akademike, bashkimit me të tjera IAL sipas interesave strategjike, si edhe miraton: “buxhetin vjetor dhe semestral të institucionit dhe mbikëqyr implementimin e tij; aprovon strukturën e përgjithshme të universitetit “Epoka”; numrin e personelit në të gjitha nivelet; cakton rregullat për menaxhimin e të ardhurave të siguruara nga universiteti përgjatë ushtrimit të aktivitetit të tij”.

Senati Akademik është një organ kolegjal i vendim-marrjes, i cili përcakton: “zhvillimin e politikave të institucionit; i planifikon ato; i koordinon; i drejton; kontrollon aktivitetin mësimor dhe akademik; vlerëson efikasitetin; vendos mbi problematikat që mbart institucioni në lidhje me aktivitetet e mësimdhënies ose të kërkimit shkencor”.

Rektorati i universitetit është një organ ekzekutiv. Rektorati përbëhet nga Rektori; Dekanët e Fakulteteve; Administratori i Universitetit; Dekani dhe zv/Dekani i studentëve si dhe përgjegjësi për çështjet ligjore. Ndër funksionet e Rektoratit mund të permendim: rekomandime për Senatin Akademik mbi ndryshimet e nevojshme strukturore për realizimin e programeve të studimit dhe projekteve kërkimore; përgatit një raport të detajuar vjetor mbi aktivitetet e institucionit i cili aprovohet nga Bordi Administrativ dhe Senati Akademik; monitoron dhe publikon rezultate e vlerësimit për aktivitetet e universitetit; ndjek implementimin e vendimeve të marra nga Senati Akademik dhe Bordi Administrativ; i propozon Bordit Administrativ caktimin, promovimin, shkarkimin e personelit akademik, administrativ dhe personelit ndihmës bazuar në propozimet e Dekanatit; i propozon Bordit Administrativ hapjen, mbylljen, ndryshimin e njësive bazë ose të njësive tjera; mbikëqyr aktivitetin e institucionit dhe propozon tek autoritet kopetente masat e nevojshme për të siguruar mbarëvajtjen e universitetit.

Aktualisht universiteti ka një numer prej 1700 studentësh në të gjitha nivelet e studimit 10% e të cilëve janë student të huaj. prej të cilëve 10% janë studentë ndërkombëtar. Universiteti ofron citojme: 10 programe Bachelor, 9 programe Master i Shkencave, 7 programe Master Profesional, 2 programe të ciklit të dytë të integruar dhe 6 programe Doktorature. Pothuajse të gjitha programet e studimit ofrohen në anglisht. Universiteti “Epoka” zbaron Kartën e Bolonjës jo vetëm duke ofruar programe mësimore në të tre ciklet e studimit, adopton sistemin me kredite ECTS, si dhe ofron suplementin e diplomës për të gjithë të diplomuarit. Universiteti “Epoka” ka marreveshje bashkepunimi me insitucione te ndryshme publike dhe private si dhe partnere akademike ndërkombetare. Universiteti merr pjese edhe në projekte te financiuara nga programet e BE-se sic janë: programi TEMPUS apo tre projekte në programin Erasmus + KA2 (Horizon 2020).

Departamenti përgjegjës për programin e studimit Master i Shkencave në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare është Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënie

Ndërkombëtare, i cili ka qene pjese e Fakulteti te Shkencave Ekonomike dhe Administrative. Me riorganizimin e Universitetit ne tre njesi kryesore me Urdher MASR Nr. 116, date 13.07.2017 dhe bazuar në Vendimin e Senatit Akademik Nr.02, datë 28.09.2017 ky departament është pjesë e Fakulteti të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale. Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare ofron programe të nivelit Bachelor, Master dhe PhD. Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare është një njësi bazë e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale.

Në vitin 2017, Universiteti “Epoka” plotësoi kushtet për akreditimin institucional nga ASCAL. Në përputhje me legjislacionin e arsimit të lartë në fuqi, programi i studimit Master i Shkencave në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare me një kohëzgjatje të rregullt prej dy viteve akademike (120 ECTS) është licencuar sipas Urdhrit nr. 338, datë 14 gusht 2012, të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ: Bordi i Akreditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, vendosën: PhD Elvin Gjevori dhe PhD Gert Guri ekspertë të jashtëm vlerësimi për këtë program studimi.

Gjatë gjithë procedurës, ekspertët e jashtëm të vlerësimit janë asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL: Znj. Xhiliola Bixheku.


Me datë 23.07.2018 dërgohet në Institucion Draft Raporti i Vlerësimit të Jashtëm i hartuar nga ekspertet e vlerësimit. Më datë 26.07.2018 Institucioni sjell në ASCAL komentet në lidhje me Draft – RVJ. Institucioni shpreh dakordësinë me përmbajtjen e këtij Draft Raporti.

Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKKREDITIMIN E PARË

I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit

- a) Pasqyrat financiare dhe burimet e të ardhurave si dhe menaxhimi i tyre duhet të shoqërohen me një analizë të hollësishme të shpenzimeve të shoqëruara me pranimet përkatëse;
- b) Të zgjerojë bashkëpunimin me vendet perëndimore në mënyrë që të arrihet një ekuilibër më i mirë midis institucioneve homologe në Lindje dhe Perëndim;
- c) Të ofrojë temat dhe fushat në të cilat do të bazohen tezat e studentëve të Masterit;
- d) Të sigurojë që studentët të dorëzojnë në fund të programit një certifikatë të njohur ndërkombëtarisht të gjuhës angleze.



II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

- a) Për të përmbushur këtë rekomandim, institucioni ka krijuar një zyrë të vecantë finance e cila në bashkëpunimin me kompaninë e cila ka në pronesi këtë univesitet menaxhon burimet financiare. Nga vizita në institucion u informuam që kompania mëmë e institucionit bën një analizë të hollësishme të shpenzimeve e cila më pas përdoret për formulimin e buxhetit të universitetit i cili është i pavarur dhe administrohet nga instancat e universitetit.

GVJ vlerëson se rekomandimi është përmbushur plotësisht.

- b) Për rekomandimin mbi zgjerimin e bashkëpunimit me institucionet homologe si ne lindje ashtu edhe ne perendim, institucioni ka ndermarre nje sere marreveshesh bashkëpunimi si bilaterale ashtu edhe ne kuader te disa projekteve nderkombetare sic jane Erasmus + ku universiteti ben pjese. Keto krijojne jo vetem mundesi te mira shkembimi eksperience per stafin akademik por edhe rrisin mobilitetin nderkombetar te studenteve. Sic shihet edhe nga tabelat 42, 44, 46, 47 dhe 48 (te cilat i refrohen kapitulliut te 11 te RVB-se) lidhur me bashkëpunimin nderkombetar eshte krijuar nje eksperience pozitive bashkëpunimi me mjaft univesitete si persa i takon marreveshjeve kuader por me shume duhet te behet ne arritjen e marreveshjeve te cilat kane ne focus kete program masteri. Aktualisht ka shkembime pedagogesh kryesisht per leksione hapura por jo ne nivel me te strukturuar dhe afatgjate (sic do te ishte joint apo double-degree) Ka nje pjesmarrje te kenaqshme te Universitetit ne projektet e BE-se per mobilitetin e studenteve dhe te pedagogeve, ndersa per keta te fundit universiteti mbulon edhe shpenzimet ne rast pjesmarrjeje ne takime nderkombetare apo prezantime te punes akademike. Megjithate me shume duhet te behet ne drejtim te nje ekuilibrimi lindje-prendim me te drejte si persa i takon partenereve akademike ashtu edhe studenteve qe shkembehen brenda ketij programi.

GVJ vlerëson se rekomandimi është përmbushur plotësisht.

- c) Për rekomandimin mbi ofrimin e temave dhe fushave në të cilat do të bazohen tezat e studentëve të Masterit, institucioni ka caktuar mentors per studentet. Ne bashkëpunim ata vendosin tematiken e tezës e masterit shkencor. Nderkohe qe mentori ndihmon studentet ne procesin e udhëheqjes se tezës (planifikimin dhe shkrimin e saj). Ne rregulloren e masterit percaktohet qarte se tematikat fillimisht miratohen nga departamenti, i cili me pas realizon edhe individualizmin e pedagogut i cili do te ndjekje studentin gjate punes se tezës.

GVJ vlerëson se rekomandimi është përmbushur plotësisht.

- d) Për rekomandimin mbi garantimin e pajisjes se studenteve me një certifikatë të njohur ndërkombëtarisht të gjuhës angleze, te cilen studentët të dorëzojnë në fund të programit, institucioni ka ndermarre hapat e nevojshme pasi permbushja e ketij detyrimi eshte jo vetem

parakusht për diplomimin e studenteve pranë universitetit, por edhe vete programi është organizuar dhe zhvillohet në gjuhën angleze.

GVJ vlerëson se rekomandimi është përmbushur plotësisht.

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Ky program mesimor ofron një sërë objektivash, por qëllimi kryesor është rritja e nivelit të mesimdhënies cka do të mundesoje edhe arritjen e rezultateve të planifikuara në periudhë disavjeçare (2017-2022). Për të arritur këtë qëllim janë vendosur një sërë objektivash siç janë rritja e nivelit shkencor të pedagogëve si nëpërmjet avancimit në karrierën e akademike (ka ngritje në një shkallë akademike të pothuajse të gjithë pedagogëve të programit në periudhën nga akreditimi i fundit) ashtu edhe në pjesëmarrjen në konferenca apo projekte shkencore ndërkombëtare. Megjithatë, një kujdes me i vecantë duhet treguar në shpjegimin nëpërmjet deliverables konkrete se çfarë synohet në çdo fazë të caktuar dhe me çdo objektivi. Ky hap do të kërkonte edhe ndarjen në nen-objektiva apo hartimin e strategjive afat-shkurtra, afatmesme dhe afatgjata. Për shembull mund të theksohet se brenda një periudhe 3 vjeçare do të kemi avancimin e 3 pedagogëve në nivelin tjetër akademik dhe rritjen me të paktën 10% të pjesëmarrjes së pedagogëve të programit në botime periodike të kësaj fushe si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtare. Një strategji me hapa të ndërmjetme dhe deliverables konkrete mund të ndiqej edhe për rritjen e numrit të studenteve, e cila me të drejtë (duke konsideruar numrin relativisht të ulët të tyre) duhet të jetë një nga objektivat kryesore për zhvillimin e programit në periudhën afatshkurter dhe afatmesme. Në periudhën afatmesme dhe afatgjatë duhet patur parasysh që rritja e numrit të studenteve, siç theksohet në strategjinë e zhvillimit të IAL, nuk duhet të çojë në cilësinë e ofruar aktualisht me një numër më të vogël studentesh.

Objektivat e Masterit janë parashtruar në përputhje me objektivat e institucionit i cili në të njëjtën periudhë kohore e fokuson aktivitetin e tij në të njëjtat objektiva siç janë rritja e numrit të studenteve, ndërkombëtarizimi i studenteve pjesëmarrës dhe rritja e nivelit të mesimdhënies nga ana e pedagogëve.

IAL ofron edhe një infrastrukturë të përshtatshme për këtë qëllim duke filluar nga biblioteka deri tek abonimet në revistat e specializuara për këtë program.

Tabela 2: Numri i studentëve të regjistruar ndër vitë në programin e studimit Master i Shkencave në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare

Viti Akademik	Numri i Regjistrimeve
2015-2016	4
2016-2017	6
2017-2018	8

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion:

➤ Nevojat e tregut të punës

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve ¹
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;	<p>Si në shpjegimet e dhëna në RVB ashtu edhe në dokumentat e paraqitura ka një ndërlidhje ndërmjet misionit dhe objektivave e strategjive afatshkurtra dhe afatmesme të programit. Keshtu edhe në këto master ashtu si edhe në misionin e IAL punësimi i studenteve është pjesë e misionit, nderkohe që për vetë profilin e programit institucionet publike por edhe ato ndërkombetare mbeten një alternative kryesore. Sic u tha edhe më lart ka një përputhje të kënaqshme të programit të studimeve me misionin dhe qëllimin e institucionit duke të marrë parasysh karakteristikat e programit.</p> <p>Zhvillimi i programit në gjuhën angleze është padyshim një argument i saktë në shpjegimin e potencialit të punësimit që ofron programi (duke mundësuar punësimin edhe jashtë vendit). Studimi “The Graduate Outcomes in the Labor Market” shpjegon jo vetëm menyrat që ndiqen për të kuptuar nëse programet akademike kanë një përputhje me kërkesat e tregut të punës, por edhe avantazhin që programi në fjalë ka me të tjerë IAL që ofrojnë këto tematike masteri (natyrisht gjuha angleze është një prej tyre).</p> <p>Në informacionin e ofruar si në RVB ashtu edhe në analizen e nevojave të tregut të punës ofrohet një pasqyre e fushave kryesore të zhvillimit të nevojave që ka vendi për eksperte të këtij profili. Përveç përpjekjeve për një përputhje sa më të plotë është pozitiv fakti që ekziston një mekanizëm i cili monitoron vazhdimisht dinamikën e ndryshimeve dhe i pasqyron ato në silabuset dhe temat e programit.</p> <p>Informacioni i paraqitur shpjegon në mënyrë të qartë se si vlerat kulturore dhe politike të vendit si një shtet demokratik promovohen dhe ruhen nëpërmjet jo vetëm leksioneve frontale por edhe detyrave të kursit me</p>
Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	
Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;	
Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.	

¹ GVJ duhet të shprehen me shkrim për çdo standard në mënyrë të përmbledhur (mbështetur në kriteret majtas). Në fund të çdo rubrike, grupi duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardeve në tërësi.



	tematika nga sfidat dhe objektivat e integritit te shtetit dhe shoqerise shqiptare.
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;	Programet e studimeve jane pershtaur me strategjine e zhvillimit te institucionit si persa i takon objektivate te zhvillimit (rritja e nivelit te mesimdhënies dhe numrit te studenteve) por edhe ne periodizimin e proceseve ne etapa te percaktuara qe synojne permbushjen ne hap ate planifikuara te misionit te institucionit, sic shpjegohet ne dokumentin mbi objektivat dhe misionin e programit ne fjale.
Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.	
Kriteri 1 Përmbajtja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;	Permbajtja e programeve eshte hartuar duke permbushur normat ligjore dhe nenligjore ne fuqi si edhe dispozitat dhe rregulloret e enteve pergjegjes sic jane Ministria e Arsimit Rinise dhe Sporteve apo ASCAL. Akreditimi i mëparshëm ka dhënë një ndihmesë në këtë drejtim, por vihet re edhe një kujdes i vazhdueshëm në përmbushjen e kriterëve ligjore.
Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.	Emertimi i programit te studimit te ofrurar dhe njohurite ne dispozicion te studenteve qe marrin pjese ne program jane ne perputhje me nivelin 7 te Kornizes Shqiptare te Kualifikimit dhe me karten e Bolonjes.
Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.	
Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;	Institucioni ka hartuar dy plane strategjike: i pari per periudhen 2013-2017 dhe i dyti per periudhen 2018-2022. Ne keto plane shprehen qarte jo vetem objektivat por edhe mekanizmat check&balance qe ka ndertuar institucioni per te vleresuar progresin e arritur ne permiresimin e programeve te studimeve - vecanerisht ne seksionin e planit strategjik kushtuar zhvillimit dhe përmirësimit te Programeve të Studimeve - por dhe per te marre masa korrektuese atehere kur eshte e nevojshme.
Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.	Vlerësohen arritjet në mënyrë periodike nga grupi i punës i cili propozon ndryshimet e nevojshme në program kur objektivat nuk janë arritur. Në planin strategjik, IAL paraqet procedurat dhe planet për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit Harmonizimi i planit strategjik te programit me strategjine e universitetit ka bere te mundur qe te trajtohen ne nivelet e duhura sfidat qe kane te bejne me permiresimin e mesimdhënies. Disa prej tyre mund te adresohen vetem ne nivel IAL ndersa disa te tjerat jane specifike per programin.
Konkluzionet e vlerësimit:	
1. Programi ka nje vizion te qarte strategjik i cili perputhet jo vetem me misionin e institucionit	

por edhe me dispozitat ligjore dhe nen-ligjore.

2. Institucioni ofron programe të cilat janë në përputhje me misionin e tij dhe strategjitë afatshkrutra dhe afatmesme të zhvillimit, si edhe një procedurë periodike për vlerësimin dhe përmirësimin e programeve mësimore.
3. Programi merr në shqyrtim por edhe institucioni ofrojnë mekanizma funksionale për të kontrolluar progresin e rritur dhe për të ndermarre hapat korrektive të nevojshëm.

Rekomendim : *Sygjërim: kryerja e një studimi apo një paraqitje me e sakte e kërkesave të tregut të punës nepermjet proxy-indikatoreve si p.sh. fakti që 90% e studenteve të diplomuar janë punësuar është një tregues i përputhjes së programit me nevojat e tregut.*

Standartet përmbushen

2. Struktura akademike e Fakultetit (departamentit përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Njesite e fakultetit janë të organizuara në përputhje me dispozitat ligjore, ndërsa vihet re një kujdes për të zbatuar procedurat të cilat bëjnë vlerësimin e nivelit të mesimdhënies dhe marrin masa korrektuese, si edhe një ndërveprim ndërmjet strukturave akademike dhe atyre manaxheriale. Stafit i prezantuar ka një nivel më të lartë se kërkesat ligjore (si përsa i takon numrit ashtu edhe gradave akademike) duke krijuar mundësi për një mesimdhënie cilësore. Megjithatë grupi akademik ka funksione propozuese, përsëri marrja e vendimeve në nivel rektorati siguron përcjelljen e nevojave të evidentara nga njesite dhe stafit akademik në nivelin manaxherial.

Dekanati i Fakultetit si organi kolegjal vendimmarrës përcakton dhe organizon angazhimin e burimeve njerëzore dhe materiale të Fakultetit, mbështetur mbi propozimet e përkatëse të departamenteve.

Këshilli i Profesorëve fokusohet në mbarevajtjen dhe përcaktimin e studimit doktorale në Fakultet. Anëtarët e këtij organi përzgjidhen në baze të përvojës dhe kompetencave të tyre dhe janë pjesë e stafit akademik të Universitetit Epoka, por edhe nga universitete të tjera brenda dhe jashtë vendit.

Departamenti është njësi bazë e punës mësimore, kërkimore dhe shkencore për secilin nga programet akademike dhe roli i tij është jo vetëm të stimulojë dhe bashkërendojë mesimdhënien në nivelet e ndryshme të programeve që ofron, por edhe të bashkërendojë punën në drejtim të kërkimit akademik. Departamenti propozon drejtimet strategjike dhe ndryshimet përkatëse përsa i takon kurrikulave, përcakton programet si edhe evidenton nevojat për staf akademik pranë dekanit të fakultetit dhe rektorit të universitetit.

Përgjegjësi i Departamentit është autoriteti më i lartë i njësisë mësimore-kërkimore dhe është përgjegjës për veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore në secilin nivel akademik të departamentit si edhe dhe për drejtimin sa më efikas të aktiviteteve brenda tij. Përgjegjësi i Departamentit përfaqëson dhe vepron në emër të Departamentit dhe është pjesë e personelit akademik dhe është të paktën me gradën Doktor Shkencash.


Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Struktura akademike e Fakultetit

Fakulteti

Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale prane të cilit është mbështetur edhe programi i studimit Master i Shkencave në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare konsiston në tre njësi bazë (2 departamente dhe një qendër kërkimore)

- Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare;
- Departamenti i Drejtësisë; dhe
- Qendra për Studimet Europiane



Sic shihet edhe nga skema e organizimit të fakultetit e prezantuar në RVB ka një ndarje ndërmjet Dekanatit i cili ka funksione me menaxheriale dhe Asamblese të stafit akademik. Ky është një organizim pozitiv pasi krijon mundësinë që stafi akademik të ketë një zë të pavarur nga Dekanati duke krijuar një ekuilibër check&balance për të përfaqësuar interesat akademike përpos atyre menaxheriale. Vlen të theksohet edhe ekzistenca e një komisioni të vecantë për të takon programet doktorale cka

krijon mundesine qe fakulteti te harmonizojë ne menyre efektive kurrikulumet akademike ndermjet ketyre te tre niveleve (Bachelor, Master dhe PhD). Per me tej edhe prezenca e nje keshilli profesorësh i krijuar nga dy fakultetet ai i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale dhe i Shkencave Ekonomike dhe Administrative krijon mundesine e promovimit te programeve inter-disiplinare sic eshte edhe programi i marre ne shqyrtim.

Fakulteti ofron një seri programesh mësimore në të gjitha nivelet nga Bachelor tek Master Shkencor si edhe programe doktorale duke krijuar kështu mundësinë e formimit të njohurive dhe kompetencave jo vetëm nga ana e studentëve por edhe e stafit akademik. Fakulteti ka evoluar në zhvillimin e tij për të përmbushur më mirë nevojat dhe sfidat e parashtruara.

Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës

Departamenti përgjegjës për programin e studimit Master i Shkencave në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare është Departamenti Shkencave Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare i cili ka qene pjese e Fakulteti te Shkencave Ekonomike dhe Administrative. Me riorganizimin e Universitetit ne tre njesi kryesore me Urdher MASR Nr. 116, date 13.07.2017 dhe bazuar në Vendimin e Senatit Akademik Nr. 02, datë 28.09.2017 ky Departament është pjesë e Fakulteti të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale.

Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Nderkombetare, miraton programet mesimore dhe propozon ndryshimet e nevojshme fakultetit. Ne kete departament (shih tabelen 2 ne aneks) japin mesim 13 pedagoge prej te cileve 9 jane PAE dhe 4 jane PAK. Ndermjet PAE 6 jane me tituj dhe grada: 4 doktor shkencash dhe 2 profesore te asociuar ndersa pjese e mbetur jane personel akademik ndihmes i perbere nga PAE ne procesin e marrjes se grades doktor shkencash. Persa i takon PAK numri i atyre te cilat kane grada akademike eshte si vijon: 1 profesor, 2 profesore te asociuar dhe 1 Msc. Persa i takon raportit PAE/PAK ne departamentin e Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Nderkombetare sipas gradave situata paraqitet si vijon: ne nivelin profesor PAE 0/ PAK 1; ne nivelin profesor i asociuar PAE 2/ PAK 2; ne nivelin doktore shkencash PAE 4/ PAK 0; ne nivelin pedagoge ne procesin e marrjes se grades doktor shkencash PAE 5/ PAK 1.

Ne dy vitet e fundit ka nje stabilitet persa i takon pedagogeve dhe lendeve qe ata mbulojne me perjashtim te rastit qe nje PAK me graden Prof. Asoc. ne vitin akademik 2016-2017 eshte punesuar si PAE ne vitin akademik 2017-2018, nderkohe qe lenda e mbuluar dhe ngarkesa kane mbetur te njejta.

Departamenti ka nje staf administrativ prej 4 personash duke e ofruar keshtu nje raport 15:4 (ose gati 3:1) ndermjet stafit akademik dhe atij administrativ. Stafi administrativ mbulon pozicionet e meposhtme: koordinatorë departamenti, koordinatorë ne zyren e regjistrimit dhe dy specialiste ne zyren e regjistrimit.

Ne te dhenat e ofruar bie ne sy se ne programin e ofruara per akreditim te gjithe pedagoget PAE jane me grada shkencore (100%) nderkohe qe ky numer eshte pak me i larte se 50% per departamentin prane te cilin eshte atashuar programi.

Dokumentacioni perkatës i marrë në vizitat në institucion

- Stafi i Departamentit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare në dy vitet e fundit
- Lista e Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK) në Departamentet perkatëse
- Ngarkesa e stafit akademik në programe të tjerë

Vlerësimi sipas standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p> <p>Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p> <p>Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p>Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore "Doktor".</p>	<p>Organizimi i institucionit, i cili ka në përbërje 3 fakultete (dhe departamentet perkatëse) krijon mundësinë për zhvillimin e një masteri interdisiplinar, i cili mbështetet nga kontributi jo vetëm i departamentit perkatës por edhe nga fakultetet e tjera (si Fakulteti i Ekonomise). Organizimi i institucionit harmonizon strukturat akademike me ato vendim-marrese dhe administrative. Strukturat akademike jane te nderlidhura dhe propozojne prane strukturave manaxheriale ndryshimet e nevojshme.</p> <p>Universiteti Epoka eshte i organizuar ne tre fakultete: Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative; Fakulteti i Inxhinierise dhe Arkitektures; Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Sociale duke përmbushur kështu dispozitat ligjore. Fakultetet jane te organizuara ne se paku tre njesi baze, te cilat konsistojne ne departamente ose qendra kerkimore. Fakulteti i cili organizon programin e marre ne shqyrtim eshte organizuar ne tre njesi baze: dy departamente: Departmenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare si edhe Departmenti i Drejtësisë; dhe nje qender kerkimore: Qendra për Studimet Europiane. Te trija keto njesi funksionojne ne baze te objektivave dhe misioni te mire-percaktuar dhe nderthurur me strategjine e zhvillimit te universitetit 2017-2022.</p> <p>Departamenti ka ne perberjen e tij 9 anetare efektive nga cilet 2 mbajne graden profesor i asociuar dhe 4 mbajen graden doktor shkencash duke plotesuar keshtu kriterin e parashikuar nga dispozitat ligjore.</p>
Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.	

<p>Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>Në informacionin e paraqitur në rregulloren e programit të masterit, apo në dokumentin “Example of Student Survey” përshkruhen procedurat dhe mekanizmat që janë vendosur për të siguruar realizimin e programeve të studimit dhe kontrollin e cilësisë. Procedurat të cilat sigurojnë realizimin e programeve janë p.sh. ballafaqime periodike me studentët dhe organizimi i pyetësorve me studentët, frekuenca me të cilën ripërtërihen programet mësimore, etj. Njesite baze kane objektiva te qarta persa i takon realizimit te programeve te studimeve, te cilat harmonizohen ne nivel fakulteti dhe universiteti. Zbatimi i procedurave per kotrollin dhe permiresimin e vazhdueshem te cilesise se mesimdhënies jep nje ndihmese te qarte ne kete drejtim.</p> <p>Procesi i paraqitur, ne rregulloren e programit, qe nga evidentimi i nevojës për pedagogë (nga departamenti) dhe aprovimi (nga ana e rektoratit), frekuenca vjetore e paraqitjes së nevojave dhe marrja në punë e personelit në kohë të percaktuar për të siguruar plotësimin e kërkesave të bera nga departamenti, dëshmon për një pjesëmarrje të personelit akademik në të gjitha hapat e rekrutimit.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ka një organizim të kënaqshëm të strukturës së fakultetit duke harmonizuar njesite baze me procesin e vendim-marrjes por edhe me bashkërendimin e punës ndërmjet tyre (siç është rasti i këshillave të profesoreve inter-disiplinare) apo bashkëpunimi ndërmjet niveleve të ndryshme akademike (bachelor, master dhe doktorature). 2. Organizimi i strukturave të fakultetit dhe departamentit përmbushin kërkesat ligjore. 3. Numri i pedagogëve efektive si edhe niveli i tyre akademik është me i lartë se kriteret e paraqitura nga dispozitat ligjore. <p>Standartet përmbushen</p>	

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Kualifikimi i personelit akademik është në një nivel të kënaqshëm siç është numri i pedagogëve në raport me studentët ashtu edhe kualifikimit të tyre (të gjithë kanë të paktën gradën doktor dhe janë diplomuar jashtë vendit). Në vitin akademik 2017-2018, raporti i studentëve me personelin akademik është 10/14 ndërsa raporti i studentëve me PA është 4/14. Në të gjithë periudhën e akreditimit të programit aktiviteti akademik është mbuluar teresisht nga PAE, ndërsa për vitin akademik 2017-2018 ky raport është PAE/PAK 10/0. Në këtë vit akademik kemi një shpërndarje të

titujve ne program si vijon: 1 profesor, 2 profesore te asociuar dhe 6 doktore shkencash (nje informacion me i plote ofrohet ne seksionin perkates.

Përsa i takon raportit midis femrave dhe meshkujve te PAE qe japin mesim ne kete program vihet re një lloj njëanshmërie si ne numer ashtu edhe ne cilesine e gradave. Keshtu persa i takon raportit ai eshte 8/2 ne favor te PAE meshkuj ndersa kemi vetem nje profesore te asociuar femer dhe vetem nje doktore shkencash. Kjo lloj njeanshmeri vihet re ne te gjitha vitet akademike te programit.

Një tjetër aspekt që meriton vëmendje, i cili është sqaruar më në detaje në seksionin përkatës, është edhe ai i shpërndarjes se njetrajtshme moshore e cila per PAE është përqendruar kryesisht në moshën 32-40 për gradën doktor 3 profesore te asociuar ne moshen 36-55 vjec dhe 1 profesor ne grup-moshen 36-45 vjec. dhe për moshën mbi 66 vjeç për gradën profesor.

Ka një numër të lartë pedagogësh për numrin e studentëve të regjistruar në këtë program (10 pedgoge per 14 studente) dhe nje shperndarje brenda kuadrit ligjor për ngarkesën që këta pedagogë dedikojnë në programin e paraqitur për akreditim. Kështu pjesa më e madhe e PAE me gradën doktor kanë një ngarkesë më të ulët se 200 orë, ndërsa përgjegjësi i departamentit ka një ngarkesë të përgjithshme me te ulet duke patur parasysh edhe aspektet administrative dhe kërkimore të pozicionit. Ne kete zgjidhje ka ndikuar edhe rregullorja e programit sipas te ciles ne shperndarjen e ngarkeses mesimore merret parasysh grada dhe ngarkesa institucionale e pedagogut (shih per me shume aneksin on the Teaching Load).

Procesi i rekrutimit behen duke ndjekur procedura publike dhe nga kriteret te percaktuara qarte ne rregulloret e institucionit dhe mbi nje baze transparente te paraqitjes se kriterëve duke respektuar keshtu dispozitat ligjore (shih aneksin mbi Rregulloren e Punesimit dhe Vleresimit te Performances se Stafit Akademik). Ne dokumentacionin e paraqitur janë peraktuar dy tipologji të veçanta kontratash për personelin PAE dhe PAK. Kjo edhe duke patur parasysh profilet, kërkesat dhe angazhimin e ndryshëm të këtyre dy figurave pranë Institucionit

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- ☑ Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat, (Tabelat në Aneks)

Në Tabelat 1 (shiko Aneks) prezantohet numri dhe gradat e pedagogëve të angazhuar në programin Master Shkencor në Shkencat Politke dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare për vitin akademik 2017-2018 dhe për vitet e tjera që prej akreditimit të parë të këtij programi studimi.

Per vitin akademik 2017-2018 ka nje nivel te kenaqshme te PAE si ne drejtim te numrit 10 pedgoge ashtu edhe persa i takon nivelit te tyre akademik: grada me e ulet eshte ajo e doktorit, nderkohe qe ka nje profesor dhe 3 profesore te asociuar. Numri i PAE ka ardhur gjithnje ne rritje me kalimin e viteve cka mendojme se ndikon poitivisht ne cilesine e mesimdhenies. Megjithate, bie ne sy fakti se nuk ka asnje PAK ne program, ndoshta edhe per vete numrin e larte PAE (aktualisht raporti personel akademik student ne program eshte 10 pedgoge per 14 studente).


Duke qene se institucioni ndjek nje politike per mesimdhene ne kete program vetem nga PAE (me perjashtim te vitit akademik 2016-2017) per pothuajse te gjitha vitet akademike qe nga akreditimi i fundit i programit, do te paraqesim ne vijim pasqyren e perberjes dhe gradave te PAE qe marrin pjese ne kete program per te gjitha keto vite akademike:

1. Për vitin akademik 2017-2018 gradat e 10 PAE të programit janë si vijon: 1 Profesor, 3 Prof. As, dhe 6 PhD/Dr.
2. Për vitin akademik 2016-2017 raporti i numrit PAE/PAK është 9/1. Gradat e pedagogëve të programit janë si vijon: PAE janë 4 Prof. As dhe 5 PhD/Dr. Ndërsa PAK eshte vetem 1 Prof. As. Përsa i takon raportit të mësimdhënies është 95% PAE dhe 5% PAK.
3. Për vitin akademik 2015-2016 gradat 7 PAE të programit janë si vijon: 6 Prof. As, dhe 1 PhD/Dr.
4. Për vitin akademik 2014-2015 gradat 8 PAE të programit janë si vijon: 7 Prof. As, dhe 1 PhD/Dr.
5. Për vitin akademik 2013-2014 gradat 5 PAE të programit janë si vijon: 5 Prof. As.
6. Për vitin akademik 2012-2013 gradat 5 PAE të programit janë si vijon: 5 Prof. As.

Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare për të plotësuar nevojat e mësimdhënies dhe kërkimit përfshin edhe asistentët mësimdhënës, te cilet nuk janë personel akademik dhe nuk janë të punësuar, por janë studentë të programeve master të universitetit, te cilet ndihmojnë si pedagoget ne mësimdhënie dhe aktivitetet kërkimore. Ne kete vit akademik jane 4 asistentë ne mesimdhene; dy janë efektiv dhe 2 janë me kohë të pjesshme. Kjo formulë është aplikuar nga ky universitet që nga viti akademik 2017-2018.

- Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinatorit/ët e programit të studimit (Plotëso Tabelat në Aneks, të cilat mund të plotësohen edhe nga verifikimi i tabelave të paqyruara në RVB)

Në Tabelën 3 (shiko Aneks) janë paraqitur anëtarët e Këshillit Shkencor te programit. Keshilli shkencor ka 6 antetare njeri prej te cileve luan edhe rolin e korrodinatorit. Pjesmarrja eshte e kenaqshme si persa i takon numrit te pedagoqeve ashtu edhe cilesise se tyre. Keshtu ne Keshill bejne pjese 2 Prof. Assoc. 3 doktore shkencash dhe 1 Msc, i cili luan edhe rolin e koordinatorit te keshillit. Anetaret e Keshillit kane te gjithe profilin akademik (fushat e specilizimit dhe kerkimit) si edhe pervojen e nevojshme ne mesimdhene ne kete program (shume prej tyre jane qe nga viti i pare i akreditmit ne kete program). Te gjithe anetaret e keshillit shkencor jane edhe anetaret e programit. Megjithate do te ishte me frytdhenese edhe pjesmarrja e figurave akademike jashte programit te cilet mund te ofrojne nje mendim ndryshe dhe te nxisin kritiken konstruktive. Per me tej mungesa e PAK ne program ben te nevojshem qe ne Keshillin Shkencor te kete nje mendim akademik me personalitete




te kesaj fushe, te cilat nuk bejne pjese ne program, ndryshe mund te zhvillohet ne te ardhmen nje menaxhim tautologjik i programit akademik.

Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (Tabela në Aneks, të cilat janë plotësuar edhe nga verifikimi i tabelave të paqyruara në RVB)

Të dhënat sipas seksit (Tabelat në Aneks,

Stafi akademik mbulon në një nivel të kënaqshëm nevojat e programit përsa i takon ngarkesës së orëve dhe harmonizimit të tematikave të ofruara. Sikundër është shpjeguar edhe më lart, kemi një numër prej 10 PAE, te cilet mbulojnë te gjithë ngarkesen e programit ndersa nuk kemi PAK te cilet marrin pjese ne program (me perjashtim vetem vitit akademik 2016-2017). Ne te gjitha vitet akademike qe nga akreditimi i fundit vihet re jo vetem nje nivel i larte i numrit te pedagogeve por edhe nje cilesi e larte e tyre (gradat e pedagogeve jane kryesisht Prof.Asoc me perjashtim te dy viteve te fundit akademike 2016-2018. Me poshte po paraqesim nje pasqyre te stafit akademik dhe kualifikimeve te tyre duke nisur nga viti akademik 2012-2013.

- a) Për vitin akademik 2017-2018 gradat e 10 PAE (dhe 0 PAK) të programit janë si vijon: 1 Profesor, 3 Prof. As, dhe 6 PhD/Dr. Ka nje rritje te numrit te PAE ne krahasim me vitin e meparshem ndonese numri i pergjithshem i pedagogeve te programit mbetet i njejte (10). Kemi po ashtu edhe nje rritje te cilesise pasi kemi nje PAE me graden Profesor ndersa ne vitin akademik 2016-2017, kishte me shume nje PAE me titullin Prof. Asoc. Numri i PAE me graden PhD/Dr eshte rritur gjithashtu nga 5 ne 6. Keto ndryshime sjellin nje rritje cilesore te programit.
- b) Për vitin akademik 2016-2017 raporti i numrit PAE/PAK është 9/1. Gradat e pedagogëve të programit janë si vijon: PAE janë 4 Prof. As dhe 5 PhD/Dr. Ndërsa PAK është vetem 1 Prof. As. Përsa i takon raportit të mësimdhënies është 95% PAE dhe 5% PAK. Ne krahasim me vitin akademik 2015-2016 kemi nje rritje te numrit te pergjithshem te PAE nga 7 ne 9 si edhe ate te PAK nga 0 ne 1. Ndersa numri i Prof. Asoc eshte ulur nga 6 ne 5, numri i PAE me titullin PhD/Dr eshte rritur nga 1 ne 5
- c) Për vitin akademik 2015-2016 gradat 7 PAE (dhe 0 PAK) të programit janë si vijon: 6 Prof. As, dhe 1 PhD/Dr. Ne kete vit akademik kemi nje ulje te numrit te PAE ne krahasim me vitin e meparshem: 1 Prof. Asoc me pak
- d) Për vitin akademik 2014-2015 gradat 8 PAE (dhe 0 PAK) të programit janë si vijon: 7 Prof. As, dhe 1 PhD/Dr. Ne kete vit akademik ne krahasim me vitin e meparshem kemi jo vetem nje rritje si sasiore te numrit te PAE nga 5 ne 8 por edhe nje rritje cilesore: 2 Prof. Asoc. dhe 1 PhD/Dr me shume.



- e) Për vitin akademik 2013-2014 gradat 5 PAE (dhe 0 PAK) të programit janë si vijon: 5 Prof. As. Ne kete vit akademik nuk kemi asnje ndryshim si sasior ashtu edhe cilesor te PAE ne krahasim me vitin e meparshem.
- f) Për vitin akademik 2012-2013 gradat 5 PAE të programit janë si vijon: 5 Prof. As.

Të dhënat sipas seksit

Ne analizen e raportit midis femrave dhe meshkujve (shih Tabelen 4) per vitin akademik 2017-2018 vihet re një lloj njëanshmërie ne favor te meshkujve ne nje raport 8/2 (nder te cilat 1 ka graden Prof. Asoc ndersa tjera PhD/Dr.) Megjithate, ky eshte nje trend i cili vihet re pothuajse ne te gjitha vitet e akreditimit te programit me perjashtim te vitit akademik 2016-2017 kur raporti PAE meshkuj dhe PAE femra eshte 6/4 (1 Prof. Asoc dhe 1 PhD/Dr). Ne te gjitha vitet e tjera akademike ky raport eshte luhatur ne raporte favorizuese per PAE meshkuj. Keshtu ne vitin akademik 2015-2016 ky raport ka qene 7/1 (1 ka graden Prof. Asoc), ne vitin 2014-2015 ky raport ka qene 8/1 (1 ka graden Prof. Asoc). Megjithate, rritja e numrit te PAE femra ne edicionet e fundit te programit mund të jetë më e balancuar në të ardhmen duke konsideruar si numrin ashtu edhe nivelin akademik te PAE femra.

Të dhëna sipas moshës së personelit (Tabelat në Aneks)

Persa i takon moshes (shih Tabelne 5) vihet re nje shperndarje thuajse e njetrajtshme e titujve akademike ndermjet grupmoshave, e cila per PAE është përqendruar kryesisht në moshën 32-40 për gradën PhD/Dr; 3 profesore te asociuar ne moshen 36-55 vjec; dhe 1 profesor ne grup-moshen 36-45 vjec. Kjo shperndarje ndermjet grupmoshave mund te siguroje nje tranzicion fluid ndermjet brezave te akademikeve te niveleve te dnryshme. Bie ne sy fakti se ndermjet PAE nuk ka asnje pedagog me graden profesor dhe vetem 2 prej tyre jane Assoc. Prof. Dr. Ndersa persa i takon PAK kemi 1 profesor dhe nje Assoc. Prof. Dr. ne te njejtat grupmosha me PAE.

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Në aneksin e kontratave të paraqitura ne dosjen e vetevleresimit dhe verifikimit të tyre gjatë vizitës në Institucion, vihet re se institucioni pergatit nepermjet zyres perkatese kontrata te tipologjive te ndryshme sic jane me kohe te plote apo te pjesshme. Ne kontrate parashikohen ne menyre te qarte te drejtat dhe detyrimet e paleve si edhe ngarkesa e punes dhe objektivat per pedagoget dhe stafin ndihmes. Keto te drejta dhe detyrime jane pergaitur ne perputhje me statutin e institucionit.



- Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Numri i personelit ndihmes/administrativ eshte ne nivel te kenaqshem dhe raporti aktual eshte 4 staf administrativ per 10 pedagoge. Kjo eshte nje premise per te siguruar mbeshtetjen e nevojshme si persa i takon procedurave institucionale ashtu edhe ndihmes per zhvillimin e aktiviteteve mesimore. Stafi administrativ eshte ne nje raport te mire edhe me numrin e studenteve (4 staf per 14 studente) per ti dhene ketyre te fundit mbeshtetjen e nevojshme si ne nivelin procedural ashtu edhe me bazen mesimore.

Në nivelin administrativ, çdo fakultet dhe departament kanë administratorët përkatës. Funkcionon gjithashtu edhe zyra e Këshillimit të Studentëve dhe të Karrierës, e cila bashkëpunon me një staf-ndihmës pranë çdo departamenti për të koordinuar punën lidhur me nevojat e studentëve. Zyra e Marrëdhënive me Jashtë është një tjetër strukturë brenda IAL, që fokusohet kryesisht në programet ndërkombëtare dhe së bashku me Zyrën e Projekteve mbështet pjesëmarrjen e pedagogëve dhe studentëve në këto programe. Zyra e IT mbulon kryesisht infrastrukturën e IAL por edhe ndihmon në mbarëvajtjen e leksioneve (prezantimet, modulet IT brenda programit etj). Pedagogët dhe studentët kanë edhe ndihmën e Sekretarisë së Pranimi por edhe Sekretarisë Mësimore pranë çdo fakulteti. Strukturat ndihmëse ofrojnë gjithashtu mundësinë për studentët për të marrë pjesë në internship të organizuara pranë këtyre strukturave.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
- Tabelat e stafit akademik

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	<p>Lidhur me angazhimin e personelit akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ në përputhje me objektivat e programeve, ky tregues është i qartë dhe i matshem angazhimi i personelit ndihmës dhe administrativ, në sajë të informacionit mbi aktivitetet që ato mbulojnë. Përsa i takon personelit akademik zhvillohen procedura përkatëse për matjen e kësaj përpunshmërie siç janë vlerësimi i punës së stafit në lidhje me objektivat e programit të vlerësimeve. Një model i tillë vlerësimi u pa edhe gjatë vizitës në institucion në dosjet e pedagogëve.</p> <p>Ne dokumentin “Mbi punesimin dhe vleresimin e performances se stafit akademik” te hartuar nga IAL parashikohen detyrimet dhe angazhimet e stafit mësimor-shkencor ne lidhje me zbatimin e misionit te programit. Specializimi i pedagogeve, numri i</p>

	<p>tyre i larte si edhe nje numer i konsiderueshem stafi ndihmes, si p.sh. IT, sekretaria mesimore, arkiva dhe administrata krijojne kushtet per realizimin e strategjise se IAL e cila synon rritjen vecanerisht rritjen e nivelit mesimor dhe pergatitjen e studenteve me aftesi te mendimit kritik dhe zgjidhjes se problemeve.</p>
<p>Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet ne hartimin dhe zbatimin e politikave te zhvillimit te institucionit.</p>	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor ne hartimin e kurrikulës dhe ne vendimet institucionale qe i perkasin organizimit te programeve te studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Rekrutimi i personelit te ri dhe percaktimi i ngarkesës mesimore behet ne perputhje me aktet ligjore dhe nenligjore ne fuqi.</p>	<p>Organizimi institucional i departamentit dhe procedura e aprovimit te vendimeve qe zbatohet i mundeson, personelit akademik jo vetem rolin iniciues ne propozimin e ndryshimeve ne askpetin akademik por edhe ne vendimet institucionale qe i perkasin programit te studimeve. Ne te gjitha hallkat e vendimarrjes stafi akademik eshte pjesmarres. Informacioni sqarues lidhur me rolin e personelit akademik ne hartimin e kurrikulave pershkruhet ne procedurat e hartimit te programit, apo vleresimit te ndryshimit te programeve kur eshte e nevojshme. Zhvillimi i kurrikulës dhe vendimet persa i perket zhvillimit dhe organizimit te programit te studimit bazohen ne propozimet e Komitetit Shkencor te programit te studimit Master i Shkencave ne Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare. Vendimet e propozuara lidhen me zhvillimin e kurrikulës, percaktimin e lendëve, caktimin e mbikëqyrësve te tezave etj.</p> <p>Ka nje procedure te qarte rekrutimi, e cila nis nga procedurat e vleresimit deri tek ato te perzgjedhjes se kandidateve (shih dokumentin “Mbi Punesimin dhe Vleresimin e Performnces se Personelit”. Kerkesa per personel iniciohet nga stafi akademik i departamentit ne cdo fillim viti dhe procesi kryhet sipas dispozitave ligjore ne fuqi.</p> <p>Ngarkesa mesimore, sic eshte pershkruar edhe me lart, percaktohet duke u mbeshtetur jo vetem ne dispozitat ligjore por edhe ne graden dhe detyrat institucionale te pedagogut. Universiteti “Epoka” ka nje rregullore mbi “Ngarkesën Mësimore” qe rregullon ngarkesën e personelit akademik. Ne vijim te nenit 2/a te Udhëzimit “Mbi Ngarkesën Mësimore” (Aneks: 19 DVV), perllogaritja e ngarkesës mesimore te personelit akademik behet conform kontratës së punës (Aneks: 20 DVV)</p> <p>Nga verikimi i Kontratave gjate vizites konstatuam se ato ishin hartuar Konform legjislacionit shqiptar ne fuqi per punën si dhe konform ligjit 80/2015 te datës “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimit Shkencor ne Institucionet e Arsimit te Lartë ne Republikën e Shqipërisë”.</p>
<p>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente per rekrutimin dhe vleresimin e personelit.</p>	

<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>Procedura e rekrutimit është në përshtatje me aktet ligjore dhe me rregulloret (<i>Mbi Punësimin dhe Vlerësimin e Performances se Personelit</i>) dhe me statutin e institucionit (<i>neni 68, 69, 70</i>). Procedura e rekrutimit nis me evidentimin e nevojës nga ana e shefit të departamentit, e cila i përcillet dekanit dhe më pas rektorit për aprovim. Më pas bëhet publikimi i këtij pozicioni në faqen e internetit dhe testimi i kandidatëve, përzgjedhja e të cilëve kalon në dy faza: shqyrtimi i dokumentacionit dhe intervistimi i kandidatëve të përzgjedhur nga faza e parë nga një komision i posaçëm ku bën pjesë edhe përgjegjësi i departamentit.</p> <p>PAE ne kete program perbejne 100% te personelit te angazhuar ne pothuajse te gjitha vitet akademike qe nga viti i pare i akreditmit me perjashtim te vitit akademik 2016-2017 kur PAE perbenin 90% te stafit akademik ndersa PAK vetem 10%. Ne kete vit akademik ngarkesa e PAE ne program ishte 95% ndersa PAK vetem 5%.</p> <p>Procedurat e vlerësimit te personelit jane te publikuara online duke siguruar transparencen e ketij procesi dhe mbeshteten mbi dy shtylla kryesore: a) punesimi dhe vleresimi i performances se stafit (anketa te studenteve apo puna kerkimore); b) promovimi i publikimeve shkencore. Kjo siguron vleresimin si te cilesise se mesimeshenies ashtu edhe te zhvillimit akademik te stafit. Dy procedurat kryesore qe ndiqen ne vleresimin e personelit akademik jane: anketa semestrale, e cila plotesohet nga studentët për të vlerësuar personelin akademik në përfundim të semestrit; dhe pasqyra vjetore për aktivitetet kërkimore të secilit personel akademik që bëhet nga Dekanati.</p> <p>Procedura e rekrutimit ndiqet nga Zyra e Burimeve Njerezore e institucionit, e cila mban te gjithë bazen e te dhenave te vendeve vakante, nderkohe qe informacioni mbi vendet vakante i percillet edhe Sherbimit Kombetar te Punes.</p>
<p>Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.</p>	
<p>Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p>Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën</p>	<p>Pergjegjesi i programit z. Islam Jusufi ka graden doktor PhD te marre prane nje institucioni akademik nderkombetar ndersa nga informacionet e paraqitura (CV) del e qarte (ne Mbreterine e Bashkuar) se ka nje eksperience pune akademike ne universitetet perendimore, si edhe nje numer te larte botimesh ne revista nderkombetare.</p> <p>Pas konsultimit të CV të pedagogëve të programit mund të themi se të gjithë titullarët e lëndëve kanë gradën akademike “Doktor”. Sikunder eshte sqaruar edhe ne pjesen pershkrimore, verehet një lidhje të drejtpërdrejtë midis profilit të tyre akademik dhe lëndës për të cilën janë titullarë. Ne kete program</p>

<p>shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p>Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p>nje pjese e konsiderueshme pedagogesh (mesatarisht rreth 50%) kane edhe graden e Prof. Asoc ose Profesor ndersa pjesa e mbetur kane graden PhD/Dr. Pjesa me e madhe e tyre (rreth 80%) i kane perfunduar studimet doktorale jashte vendit.</p> <p>Nga organigrama institucionle dhe informacini i zyres se burimeve njerzore rezulton se Rektori, zv/rektori, dekani, zv/dekani, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin.</p> <p>Ne kete program nuk eshte e detyrueshme zhvillimi i praktikave mesimore (internship) ndonese sic na u tha ne takimin me Pergjegjesin e Departamentit gjate vizites ne institucion, ky hap stimulohet vazhdimisht. Ne rastin e organizimit te praktikave mesimore gjate vizites në institucion u informuam se personeli akademik është i mjaftueshëm për këtë mbikëqyrje, duke patur parasysh raportin ndërmjet studentëve praktikantë dhe pedagogëve të programit.</p>
<p>Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>Lidhur me procesin e perzgjedhjes dhe caktimit te tezes, Studenti bën një kërkesë për fushën e studimit përmes një propozimi për tematikë si dhe e dikuton me udhëheqësin në intervistën me komitetin shkencor të programit. Gjatë takimit me stafin akademik, gjatë vizitës në Epoka, u informuam se studentëve u ofrohen udhëheqje ne kuader te tematika te zgjedhura, duke patur parasysh interesin e tyre për tematika të veçanta. Në bazë të tematikave dhe profilizimit të pedagogëve, studentëve u përcaktohet pedagogu, i cili do ti ndjekë në hartimin e tezës. Pra zgjedhin tema (për rrjedhje dhe lëndën brenda të cilës ofrohet ajo dhe pedagogun/en përkatës/e). Ndarja e temave bëhet me miratimin e departamentit apo të më shumë departamenteve në rast se tema është interdisiplinare.</p> <p>Ne aneksin “Rregullorja e Nivelit te Dyte te Studimeve” sakesohet se udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”. Procesi monitorohet nga Komiteti Shkencor i programit të studimit Master i Shkencave në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare.</p> <p>Në dokumentin “Rregullorja e Nivelit te Dyte te Studimeve” përcaktohen kriteret e vlerësimit dhe procedurat që duhet të ndiqen gjatë shkrimit të tezës. Përsa i përket kriterit se pedagogu nuk mund të ndjekë më gjatë shkrimit të tezës më shumë se 10 studentë njëkohësisht në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore dhe humane, megjithëse nuk është përcaktuar në dokumentin e mesiperm mendojmë se plotësohet po të kemi</p>

	<p>parasysh numrin e lartë të pedagogëve në raport me numrin e studentëve. Aktualisht, numri i lartë i pedagogëve (10) në krahasim me studentet që shkruajnë tezen (aktualisht 7) siguron përmbushjen e kriterit.</p>
<p>Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</p>	
<p>Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Ne dokumentin mbi Supervizimin e Tezes së Diplomes për Programin e Ciklit të Dytet, institucioni cakton udhëheqësit e tezave në baze të përputhjes së tematikave të këtyre të fundit me profilin e akademik të udhëheqësit dhe me fushën e publikimeve. Për të përmirësuar këtë proces, profili akademik i çdo pedagogu është publik në faqen e institucionit. Edhe gjatë vizitës në institucion, gjatë takimit me stafin akademik, mësuam se pasi studenti zgjedh temën i caktohet si udhëheqës pedagogu me profilin përkatës në atë temë.</p> <p>Komitetit Shkencor i programit vendos lidhur me udhëheqësin e çdo teze duke konsideruar përputhjen midis tematikës së tezës dhe profilit akademik të udhëheqësit.</p>
<p>Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Institucioni angazhon personelin ndihmës si për ofruar një sërë programesh të cilat synojnë lehtësimin e aksesit të studentëve drejt botimeve online ashtu edhe për përgatitjen e didaktikës mesimore. Raporti i ¼ ndërmjet studentëve dhe stafit ndihmës, na shtyn të mendojmë se angazhimi i personelit ndihmës është në nivelin e kërkuar.</p> <p>Në informacionin e paraqitur në RVB lidhur me stafin ndihmës, Akademik, Administrativ por dhe në Statutin e Universitetit shpjegohet organizimi i këtyre strukturave si edhe lista e personave në secilën strukturë. Harmonizimi i angazhimit të disa pedagogëve si në procesin e mësimdhënies ashtu edhe në aktivitete ndihmëse (siç është rasti i Zyrës së Marrëdhënies me Jashtë apo i projekteve ndërkombetare) mund të ndihmojë jo vetëm në drejtim të optimizimit të burimeve por edhe për një koordinim më të mirë të këtyre hallkave, por duke mbajtur parasysh që kjo të mos sjellë një mbingarkesë, e cila mund të prekë cilësinë e punës. Stafin ndihmës ka një orar të afishuar pritjeje për studentët dhe publikun.</p> <p>Numri i lartë vecanerisht i personelit akademik në krahasim me numrin e studentëve, krijon mundësinë për një angazhim më të madh kërkimor dhe shkencor të pedagogëve, ngritja profesionale e të</p>

	cileve ne planin afatgjate kontribon ne nje perdorim optimal te ketyre burimeve.
Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>Udhezimi i institucionit “Mbi ngarkesen mesimore” (Teaching Load) (shih Aneks 19) eshte hartuar mbi bazen e dispozitave ligjore dhe merr parasysh graden dhe ngarkesen institucionale te cdo pedagogu kur percakton ngarkesen mesimore. Ngarkesa e stafit akademik është mjaft pozitive si përsa i takon lëndëve ashtu edhe përsa i takon orëve mësimore, duke bere nje përlllogaritje edhe te ngarkesës akademike që ata mund të kenë në programe të tjera të IAL. Kështu PAE me gradën doktor kanë një ngarkesë më të ulët se 200 orë, ndërsa përgjegjësi i departamentit ka një ngarkesë të përgjithshme e cila eshte ne perputhje edhe me detyrat e tij administrative (pervec atyre akademike). vihet re një ngarkesë e ekuilibruar si në numrin e orëve ashtu edhe të lëndëve, për të gjithë periudhën e akreditimit (2012-2018).</p> <p>Ne RVB ofrohet edhe link dokumentit perkates mbi këtë pikë, i cili vihet edhe ne dispozicion te publikut. Nga shqyrtimi i dokumentacionit mbi ngarkesën mësimore, mbi planet mësimore dhe shpërndarjen e pedagogëve sipas lëndëve vertetohet se ngarkesa e personelit akademik vlerësohet me orë mësimore. Kjo ngarkese përcaktohet në fillim të vitit akademik kur dhe bëhet shpërndarja e lëndëve. Secilit pedagog i kerkohet nje ngarkese mësimore në përputhje me graden shkencore dhe funksionet e tjera qe kryen prane institucionit. Personeli akademik ka lëndë sipas kriterëve të përcaktuara në udhëzimin “Mbi Ngarkesën Mësimore” të programit.</p>
Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon</p>	<p>Universiteti disponon nje baze te dhenash te hollesishme per personelin akademik dhe pjesa me e madhe e ketyre te dhenave eshte publike ne faqen e institucionit. Institucioni disponon nje bazë e plote te dhenash për anëtarët e personelit akademik të programit duke përfshirë si CV e pedagogëve (e cila disponohet nga Zyra e Burimeve Njerëzore) ashtu edhe publikimet shkencore.</p> <p>Institucioni disponon per cdo semester listen e plote te personelit akademik, liste kjo qe ne baze te dispozitave ligjore ne fuqi, i dorezohet edhe</p>

kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.	Ministrise se Arsimit (<i>referuar faqes 51 te RVB</i>). Ne baze të Rregullores “Mbi punësimin dhe vlerësimin e performancës së personelit” (<i>Aneks 7 i DVV</i>), institucioni percakton ne menyre specifike dhe publikon kriteret dhe procedurat per rekrutimin e personelit akademik.
---	---

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Institucioni ka ne dispozicion te programit nje numer te larte pedagogesh dhe stafi ndihmes duke siguruar nje ndjekje dhe angazhim pozitiv per studentet
2. Procedurat e paraqitura si persa i takon proceseve mesimore ashtu edhe atyre institucionale (sic jane ndjekja e studenteve, pjesmarrja ne vendimarrje apo proceset e rekrutimit) krijojne mundesine per permbushjen e kriteve te paraqitura.
3. Ka një përputhshmëri te kenaqshme ndermjet profilit akademik të pedagogëve dhe lëndëve që mbulojnë në program, si edhe tregohet vëmendje ne promovimin e publikimeve dhe punes shkencore nga ana e pedagogeve (cka eshte edhe pjese e vleresimit te performances se tyre).
4. Programi mbeshtetet tek PAE ne zbatimin e tij dhe vetem ne nje vit akademik kemi nje PAK. Raporti PAE/PAK dhe i ngarkesës mësimore nder vite është si vijon:
2017-2018: PAE/PAK si numër pedagogesh është PAE 100% dhe PAK 0%. PAE/PAK si ngarkesë mësimore është PAE 100% dhe PAK 0%.
2016-2017: PAE/PAK si numër pedagogesh është PAE 90 % dhe PAK 10%. PAE/PAK si ngarkesë mësimore është PAE 95% dhe PAK 5%.
2015-2016: PAE/PAK si numër pedagogesh është PAE 100% dhe PAK 0%. PAE/PAK si ngarkesë mësimore është PAE 100% dhe PAK 0%.
2014-2015: PAE/PAK si numër pedagogesh është PAE 100% dhe PAK 0%. PAE/PAK si ngarkesë mësimore është PAE 100% dhe PAK 0%.
2013-2014: PAE/PAK si numër pedagogesh është PAE 100% dhe PAK 0%. PAE/PAK si ngarkesë mësimore është PAE 100% dhe PAK 0%.
2012-2013: PAE/PAK si numër pedagogesh është PAE 100% dhe PAK 0%. PAE/PAK si ngarkesë mësimore është PAE 100% dhe PAK 0%.
5. Programi ka nje keshill shkencor i perbere vetem nga pedagoget e programit, cka mund te mos jete gjithmone pozitive pasi kufizon mendimin ndryshe dhe nxit tautologjine ne hartimin e programit mesimor (sidomos ne nje program te tille ku nuk ka PAK ne procesin mesimor).
6. Ka një shperndarje te mire moshore ndërmjet gradave akademike sidomos përsa i takon PAE. Nivelin akademik i PAE shkon pozitivisht pertej përmbushje të detyrimeve ligjore. Keshtu nga 10 PAE, 50% e tyre kane graden PhD/Dr ndersa pjesa tjeter kane graden Profesor ose Prof.Asoc.
7. Mungesa e praktikës mesimore si nje komponent i detyrueshem i programit mund te ndikojte ne jo vetem ne uljen e intensitetit dhe cilesise se bashkepunimit me partnere, por edhe nuk ndihmon mundesine e punesimit te studenteve (ne vijim te praktikës mesimore) prane ketyre institucioneve ne te ardhmen.
8. Strukturat ndihmëse dhe administrative japin një ndihmë pozitive në procesin e mësimdhënies dhe atij të kërkimit shkencor.

9. Procedurat e rekrutimit dhe vlerësimit të stafit bëhen në përputhje me normat ligjore.

Rekomandim: te shikohet mundësia e integritit të praktikës mesimore si pjesë e kurrikulumit të programit.

Standardet përmbushen

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkimore

Bazuar në RVB por edhe në vizitën në institucion, grupi i vlerësuesve të jashtëm vlerëson se kushtet infrastrukturore në të cilat zhvillohet mësimi në Universitetin Epoka janë të përshtatshme për përmbushjen e objektivave të programit nën akreditim.

Specifikisht, Universiteti Epoka ndodhet në rrugën Tiranë-Rinas dhe kampusi universitar shtrihet në një sipërfaqe totale prej 67 000 m². Viti akademik 2017-2018 po zhvillohet rregullisht në mjediset e dy godinave me sipërfaqe totale 14 352 m². Gjatë vitit akademik 2017-2018, Kampusi i Universitetit Epoka ofron 5 kalasa për leksione, 17 klasa për seminare, një sallë konferencash, tre laboratorë kompjuterikë, një laborator elektronik dhe një laborator të inxhinierisë së ndërtimit. Universiteti Epoka ofron edhe 3 salla interneti si dhe Ëi-Fi në të gjitha mjediset e universitetit. Të gjitha klasat ishin të pajisura me mjete didaktike si dhe me teknologjinë moderne që mundëson një mësim-dhënie interaktive. Në këtë kuadër, në bashkëpunim me Zyrën e Koordinimit të Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimit (ZKTIK), Universiteti Epoka ofron për studentët dhe stafin sistemin "EIS". Të gjithë përdoruesit kanë akses në informacionin e tyre personal, mund të përditësojnë të dhënat e përgjithshme dhe CV dhe mund të menaxhojnë detyra dhe aktivitete që lidhen me punën, sipas rolit dhe pozicionit të punës.

Universiteti ka gjithashtu edhe një bibliotekë moderne me një kapacitet prej 100 vendesh dhe një sipërfaqe totale prej 400 metra katror. Biblioteka përbëhet nga hyrja, salla e librave dhe e leximit. Universiteti "Epoka" është anëtar i Unionit të Bibliotekave të Ballkanit themeluar më 29 korrik 2009, me pjesëmarrjen e 10 institucioneve nga 6 vende të Ballkanit. Universiteti Epoka është gjithashtu anëtar me të drejta të plota në JSTOR, një bibliotekë dixhitale e krijuar në vitin 1995 që përmban më shumë se **2,000 revista akademike** të cilat mund të aksesohen lirisht nga stafi dhe studentët. Fizikisht, biblioteka, ka një total prej **7,500 librash** të shtypur.

Gjithashtu studentëve u ofrohen edhe një sërë lehtësishë të tjera infrastrukturore dhe teknologjike për zhvillimin e procesit mësimor. Specifikisht, **Sistemi i Menaxhimit të Mësimit (LMS)** është një

shërbim i bazuar në Moodle që iu ofrohet studentëve dhe pedagogëve me qëllim aksesin, koordinimin dhe organizimin në internet të materialeve të lëndëve. Studentët dhe pedagogët logoheshin në këtë sistem me anë të emailit zyrtar që iu jepej. Se dyti, **Karta Smart** që u jepet të gjithë studentëve dhe personelit për identifikim dhe mund të përdoret për identifikim elektronik në tri godina, dy laboratorë kompjuterikë, një laborator elektronik, në portën e kampusit dhe në pikat e hyrjes brenda godinës.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mjediset për Programin e studimit (Tabelat në Aneks)

- Salla për leksione 5
- Klasa për seminare 17
- Salla për aktivitete promovuese 1
- Salla për praktikë lëndore/ profesionale 2
- Laboratorë për lëndët 3
- Laboratorë informatike 2
- Salla interneti 2
- Salla për bibliotekë 1
- Mjedis për fotokopjime, librari etj 1
- Zyre informacioni për studentët 2
- Nyje hidrosanitare 89

Mjediset për stafin:

- Mjedise për Dekanin/ kancelarin 5
- Zyra për sekretarinë mësimore 2
- Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore 12
- Zyra për personelin akademik 40

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	
Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;	Institucioni ka një kampus rezident të përhershëm i cili ndodhet përgjatë rrugës nacionale Tiranë-Rinas. Ky kampus është në pronësi të universitetit për më shumë se 6 vjet. Mësim-dhënia zhvillohet në dy godinat kryesore të kampusit të cilat përmbushnin të gjitha standardet e kerkuara nga ligji si dhe kishin
Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të	

<p>institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p>Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>një sistem efikas mexhanimi dhe sigurie në shërbim të mësim-dhënies dhe sigurisë së studentëve në kampus.</p> <p>Ky program studimi praktikat e tij i zhvillon jashtë premisave të institucionit pranë institucioneve të tjera. Gjithësesi, Universiteti Epoka i ofronte studentëve të programit të gjithë mbështetjen e nevojshme për të ndërmarrë të gjitha aktivitetet që praktika profesionale të jetë e suksesshme dhe frutdhënëse.</p> <p>Në tërësi, infrastruktura që ofrohej nga Universiteti Epoka ishte tepër e përshtatshme për realizimin e programit të studimit.</p>
<p>Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Nga RVB-ja dhe vizita në institucion ishte e qartë se Epoka ofronte një bibliotekë moderne, me hapësirë dhe me libra bashkëkohore. Shumica e teksteve të detyrueshëm për programin e studimit ishin në bibliotekë. Tekstet të cilat nuk ishin fizikisht, mund të aksesoheshin virtualisht nëpërmjet regjistrimeve online që kishte biblioteka.</p> <p>Në bibliotekë kishte edhe shumë tekste të tjera të cilët nuk bënin pjesë në literaturën e detyrueshme të lëndëve. Mbi 7,500 tekste fizikë ishin në dispozicion të studentëve për t'u tërhequr ose për t'u lexuar në ambjentet e bibliotekës.</p> <p>Po aq e rëndësishme në bibliotekë kishte edhe botime periodikësh, sidomos revista shkencore ndërkombëtare, të cilat janë të domosdoshme për dtudentët e masterit shkencor. Akoma më mire, nëpërmjet regjistrimit në JSTOR, studentët mund t'i aksesonin këto periodikë online edhe jashtë kampusit duke e lehtësuar akoma më tepër procesin e tyre përgatitor si gjatë semestrit ashtu edhe gjatë sezonit të provimeve.</p> <p>Biblioteka kishte një praktikë ku çdo vit, pas aprovimit të instancave përkatëse, bliheshin tekstat të cilat ishin kërkuar nga pedagogë specifikë apo departamente përkatëse. Edhe pse nuk kishte një limit specifik për departament, biblioteka përpiqej që të mbante një balancë midis departamenteve.</p> <p>Oraret e bibliotekës ishin të përshtatshëm për studentët dhe i ofron atyre mundësi që ta përdornin gjatë periudhës së leksioneve. Specifikisht biblioteka ishte e hapur nga e hëna në të premte 8:30 – 17:30 si dhe të shtunën 9:00 – 13:00.</p>
<p>Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.</p>	

Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;

Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;

Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;

Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.

Siç tregohet edhe nga të dhënat e mësipërme, dhe duke patur parasysh edhe numrin e ulët të studentëve në këtë program, institucioni dëshmon se ka një sasi të mjaftueshme klasash për leksione (5), klasash për seminare (17) dhe mjedise të tjera mbështetëse për studentët gjatë procesit akademik.

Pajisjet e mjediseve mësimore, siç u bë e qartë edhe gjatë vititës në institucion ishin moderne, të mirëmbajtura dhe funksionale në shërbim të procesit mësimor. Gjithashtu stafi teknik mbështetës ishte në dispozicion të zgjidhjes së çdo problemi që mund të lindte gjatë përdorimit të tyre.

Dy sallat e internetit dhe dy laboratorët informatikë përmbanin kompjuter të cilët përmbushnin të gjithë kërkesat që mund të kishin studentët e programit nën akreditim.

Për këtë program studimi nuk ka nevojë për një laborator specifik dhe praktikat profesionale kryhen pranë institucioneve të tjera.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Kampusi i Universitetit Epoka është modern, ka hapësirë, gjelbërim dhe është i përshtatshëm për kryerjen e një procesi mësimor frut-dhënës.
2. Infrastruktura didaktike dhe teknologjike i mundëson pedagogëve të ofrojnë një mësim interkativ dhe studentëve të kenë akses 24 orë në instrumentat akademike që janë të nevojshëm për të qenë të suksesshëm.
3. Biblioteka e universitetit ishte moderne, e pasur me libra dhe e pajisur me hapësira për lexim që i krijonin studentëve kushte optimale për të lexuar dhe mësuar. Gjithashtu abonimi në JSTOR i mundësonte studentëve akses në tekstet më të fundit ndërkombëtare duke e bërë eksperiencën e tyre akademike të ngjashme me atë të kolegëve të tyre në Europën perëndimore.

Standardet përmbushen

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Universiteti Epoka financohet nga pagesat e studentëve si dhe nga fonde të tjera të fituara nga projektet e Bashkimit Europian apo partnerëve të tjerë ndërkombëtarë. Në përgjithësi, mund të thuhet se të ardhurat si rezultat i tarifave të shkollës nga studentët përbëjnë pjesën më të madhe të të ardhurave të universitetit me të cilat financohet buxheti i përvitshëm i universitetit.

Përsa i përket kontrollit dhe transparencës financiare institucioni auditohet në mënyrë të rregullt çdo vit nga një kompani e jashtme dhe e çertifikuar e auditit e cila prodhon një raport të detajuar. Gjithashtu, institucioni raporton periodikisht, sipas ligjit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për çeshtje financiare. Gjithashtu, përsa i përket menaxhimit të kapaciteteve, zyra e financës e

Universitetit Epoka në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të kompanisë “Turgut Özal Education” Sh.a – që është kompania mëmë e Universitetit Epoka - koordinojnë dhe menaxhojnë çeshtjet financiare.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje):

- Grantet për kërkim 7.2% (viti akademik 2017-18)
- Konsulencat, shërbimet 0%
- Tarifat për dhe gjatë shkollimit 92.4% (viti akademik 2017-18)
- Sponsorizimet 0%
- Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm) 0%
- Donacionet, aktivitetet siguroese, fondacione etj 0%
- Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj) 0.3% (viti akademik 2017-18)

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Për vitin akademik 2017-2018 për programin MSH në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare, Universiteti Epoka ka shpenzuar 1,089,270 ALL për pagat, ka investuar 264,358 ALL dhe ka shpenzuar 272,764 ALL. Duke patur parasysh që për këtë program studimi ka patur 8 studentë të regjistruar për herë të parë në vitin akademik 2017-2018 **kostoja e vjetore një studenti rezulton 203,299 ALL.**

Vlerësimi sipas Standardeve


Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	
<p>Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p>	<p>Turgut Ozal Education sh.a, që është edhe kompania mëmë e Universitetit Epoka, sipas kërkesave ligjore në fuqi kryen auditim vjetor të jashtëm lidhur me situatën financiare. Nga ky auditimi prodhohet një raport i detajuar i cili gjendej në zyrën e Drejtorisë së Përgjithshme të Turgut Ozal Education Sh.a. Grupi i vlerësimit nuk e kërkoi raportin pasi nuk kishte aftësi profesionale ta vlerësonte atë. Gjithësesi u informuam edhe nga vizita në institucion se raporti përmban të gjitha analizat e të dhënave mbi shpenzimet dhe të ardhurat e</p>

<p>Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>shoqërisë dhe institucioneve të përfshira, të gjitha të dhënat kontabël lidhur me të ardhurat (grantet, tarifat e studentëve) dhe të gjitha shpenzimet për shërbimet që ofron në mënyrë të direkt ose indirekt (duke kontraktuar shoqëri).</p> <p>Të dhënat e raportit përdorën nga drejtuesit e universitetit dhe kompanisë për të ndërtuar strategjinë për zhvillimin e Universitetit si dhe për të vlerësuar eficiencën e përdorimit të fondeve të universitetit në përgjethësi por edhe në këtë program studimi.</p>
--	---

Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.

<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>Duke qenë se Universiteti Epoka është në pronësi të Turgut Ozal Education sh. a., raporti financiar hartohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Turgut Ozal Education sh. a. çdo vit dhe arkivohet në këtë Drejtori. Të dhënat e raportit final dhe analizat përkatëse më pas i komunikohen Universitetit Epoka i cili propozon buxhetin e tij i cili administrohet në mënyrë të pavarur nga vetë universiteti.</p> <p>Nga vizita në institucion u informuam se të dhënat e raportit financiar zyrtar të Turgut Ozal Education sh. a., tregojnë se shoqëria ka bilanc vjetor pozitiv dhe qëndrueshmëri financiare që garanton përparimin e institucionit</p> <p>Sipas kërkesave ligjore por edhe për sa më shumë transparencë, raporti i auditit i përgatitur nga audituesi i Universitetit Epoka përmban një pasqyrë të granteve të huaja dhe shërbimeve të lidhura me kontratat për të realizuar programet e nivelit të dytë. Gjithashtu, raporti i auditit analizon efikasitetin e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e shkollimit në mënyrë që të rrisë cilësinë studimeve në këtë nivel të studimeve.</p>
--	---

<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Universiteti Epoka ndërmer një auditim të përvitshëm e të jashtëm financiar të dhënat e të cilit janë transparente e përdoren për të ndërtuar politikat e zhvillimit institucional. 2. Bazuar në raportin e auditit institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimeve dhe në bazë të të dhenave vendos për strategjinë e zhvillimit afat-mesëm të programit. <p>Standardet përmbushen</p>



6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Bazuar në kërkesat e ligjit për arsimin e lartë 80/2015 si dhe udhëzimet e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimit e Lartë por edhe vetë dispozitat e Statutit dhe Rregullores Themelore të Universitetit Epoka, institucioni ka ngritur dhe institucionalizuar sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë i cili është bazuar ne udhëzimin "Për vlerësimin akademik dhe përmirësimin e cilësisë në Universitetin EPOKA", i miratuar nga Senati i Universitetit Epoka në vitin 2009. Ky udhëzim rregullon procesin e vlerësimit mësimor, mësim-dhënien, kërkimin shkencor, zhvillimin e cilësisë, ngritjen e sistemit të brendshëm të kontrollit të cilësisë dhe vënien në zbatim të tij.

Sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë funksionon, ndër të tjera, përmes Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë (KPSC), që mbështetet nga Zyra e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë. KPSC është emërtimi i ri i njësisë së brendshme të sigurimit të cilësisë në Universitetin Epoka, pas miratimit të Statutit të ri të Universitetit në vitin 2017.

Specifikisht, KPSC, me mbështetjen e Zyrës së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë kryen vlerësime periodike të aktiviteteve të mësim-dhënies dhe kërkimit shkencor në universitet. Detyra funksionale e kësaj zyre është organizimi i pyetësorit të studentit në fund të çdo semestri për cilësinë e mësim-dhënies në lëndët e çdo programi të ofruar nga institucioni. Në këtë kontekst, KPSC përfaqëson njësinë qendrore të Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe ka të drejtë të ngrejë nënkomisione për të vlerësuar një aktivitet specifik brenda të drejtave dhe përgjegjësi të KPSC-së.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:
 - Sa anketime kanë bërë me studentët
 - Sa studentë janë anketuar
 - Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë
 - Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm
 - Etj

Institucioni nuk na dha të dhëna specifike se sa studentë janë anketuar, por bazuar në informacionin që na u dha gjatë vizitës deduktohet se të gjithë studentët janë anketuar pasi plotësimi i anketimit për lëndën ishte detyrues për të marrë rezultatin përfundimtar në atë lëndë. Të gjitha anketimet, dukë qenë

se ato bëhen online dhe janë anonime, përpunohen nga zyra e statistikave dhe i vihen në dispozicion shefit të departamentit përkatës i cili në bashkëpunim me dekanin identifikon problemet dhe mënyrat më efektive për t'i adresuar ato. Nëse problemet e identifikuar janë individuale (lidhen më një lëndë apo pedagog specifik) ato zgjidhen nga shefi i departamentit dhe pedagogu specifik. Nëse problemet e identifikuar janë sistematike (psh ka mbivendosje lëndësh ose ka lëndë të cilat vlerësohen të padobishme nga studentët) atëherë ato zgjidhen në rang institucional nga zyra që ka përgjegjësinë përkatëse e koordinuar nga shefi i departamentit.

Kontrolli i brendshëm i cilësisë


Në fund të çdo semestri, të gjithë studentët e Epoka plotësojnë elektronikisht anketime për vlerësimin e pedagogut dhe lëndës të secilës lëndë që ato ndjekin. Anketimi është standard duke u fokusuar në vlerësimin e 14 çështjeve nga ana e studentit që variojnë nga 1 (vlerësimi më i ulët) deri në 4 (vlerësimi më i lartë). Plotësimi i anketimit është konfidencial dhe i kërkohet çdo student të plotësojë, me qëllim që të shohë në sistemin elektronik notën finale për lëndën përkatëse.

Me përfundimin e anketës, sistemi elektronik nxjerr mesataren e përgjithshme të vlerësimit për çdo pedagog si dhe rezultatin për çdo komponent të anketimit (ka 14 komponentë gjithësej), duke zbuluar edhe renditjen e pedagogëve në nivel Departamenti dhe Fakulteti. Më pas, rezultatet e anketave përcillen tek zyra e Rektorit që shqyrton rezultatet dhe ia përcjell KPSC-së për një analizë të dhënash e cila më pas i bën rekomandime specifike Rektorit.

Gjithashtu, në fund të çdo semestri, KPSC me mbështetjen e Zyrës së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë, kryen analiza sasore dhe cilësore të rezultateve të studentëve për të identifikuar trende dhe problematika potenciale dhe del me rekomandimet përkatëse. Duhet theksuar se një tjetër metodë shumë efektive që përdoret për të monitoruar cilësinë e mësim-dhënies dhe vlerësimit të studentit në Universitetin Epoka është dëgjimi i shpjegimit të lëndës në auditor dhe monitorimi i punës mësim-dhënëse të pedagogut nga Dekani përkatës i Fakultetit.

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

Me monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti merret KPSC-ja dhe përgjegjësi i departamentit përkatës. Specifikisht, Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë është përgjegjës për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe akteve që miratohen nga Senati Akademik. Gjithashtu, Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë është përgjegjës për zhvillimin e standardeve të sigurimit të cilësisë në përputhje me Kodin e Cilësisë, të miratuar nga Senati Akademik. Këto detyra KPSC i zbaton nëpërmjet monitorimeve me pyetësin



në fund të çdo semestri dhe me dëgjim në leksion ndër të tjera. Komisioni bashkëpunon ngushtësisht me shefin e departamentit si për të koordinuar punën e tij ashtu edhe për të identifikuar zgjidhje ndaj problemeve të ndryshme që identifikohen gjatë monitorimeve.

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Në fund të çdo viti akademik të gjithë anëtarët e stafit plotësojnë një formular vetëvlerësimi (që lidhet edhe me një shpërblim monetar) ku ato raportojnë dhe vlerësojnë outputin e tyre akademik dhe prezantojnë një plan për vitin e ardhshëm akademik. Raporti vlerësohet nga shefi i departamentit, dekani dhe në fund nga zyra e burimeve njerëzore. Ky proces shërben edhe për të mbledhur të dhëna sasiore mbi aktivitetin shkencor të universitetit dhe cilësisë së outputit akademik për çdo departament. Në përgjithësi rezultatet e vetë-vlerësimeve janë inkurajuese dhe tregojnë se stafi akademik i Universitetit Epoka është në një nivel të lartë shkencor me botime në medime akademike prestigjioze.

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Siç është e qartë edhe nga shpjegimet e mësipërme, universiteti ka vënë në jete struktura solide dhe politika të qarta për të siguruar silësinë e brendshme ashtu siç e kërkon edhe ligji. Nga vizita konstatoam që gjendja e raportuar rakordonte me atë në terren. Pegadogët bënë vetë-vlerësim, zyra e sigurimit të cilësisë kryente sondazhet, dhe më pas të dhënat përpunoheshin deri tek zyra e burimeve njerëzore ku problematikat e identifikuar adresohen në rang individual apo departamental në varësi të problematikës.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p>	<p>Institucioni qartësisht i kryen këto procedura dhe i ka ato të institucionalizuara prej disa vitesh. Siç u tha edhe më sipër KPSC-ja organizon dhe ndërmerr sondazhe në fund të çdo semestri, administron vetë-deklarimet e pedagogëve dhe koordinon dëgjesa në leksione nga dekanët në ato raste kur konsiderohet e nevojshme.</p> <p>Rezultatet e sondazheve dhe të vetëvlerësimit i bëhen të ditura stafit (për pjesën që i takon secilit) dhe i ofrohen drejtuesve të njëjësive bazë dhe kryesore. Këto rezultate më pas përpunohen</p>

<p>a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve;</p> <p>b. Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit;</p> <p>c. Pyetje konceptuale;</p> <p>d. Intervista;</p> <p>e. Etj.</p> <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <p>a. Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj.);</p> <p>b. Dëgjime në auditor;</p> <p>c. Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë;</p> <p>d. Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;</p> <p>e. Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatat, projektet, provimet, etj.);</p> <p>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</p> <p>g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;</p> <p>h. Etj.</p>	<p>për të krijuar politika të reja apo përmirësuar ato ekzistuese. Shefat e departamenteve në raste specifike zbatojnë procedurën e dëgjimit të leksionit në auditor sidomos për stafin e ri apo të sapo punësuar në universitet. Kjo procedurë ndonjëherë realizohej edhe nga dekani i Fakultet.</p> <p>KPSC-ja nuk kontrollon direkt korrigjimet e provimeve për të parë nëse ka probleme. Gjithësesi KPSC-ja kryen analiza sasiore dhe cilësore të rezultateve të studentëve dhe del me rekomandimet përkatëse aty ku identifikon trende problematike.</p> <p>Universiteti nuk bën fokus grupe gjë e cila mund të ishte e dobishme dhe mund të përfshihet si një metodë për të marrë informacion më të thelluar rreth problematikave të caktuara në universitet.</p>
<p>Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>Stafi me të cilët ne diskutuam gjatë vizitës në institucion kishte informacion të qartë për procesin e vlerësimit të brendshëm dhe e përshkruan atë në mënyrë të ngjashme me përshkrimin që bënë drejtuesit e universitetit që do të thotë se informacioni është i bollshëm, transparent dhe i saktë.</p> <p>Në faqen e internetit të universitetit (http://aeqi.epoka.edu.al/cat-internal-audit-2326.html) kishte gjithashtu informacion të bollshëm mbi zyrën e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe informacion rreth punës e raporteve të saj. Gjithashtu në këtë faqe kishte informacion të përgjithshëm mbi qëllimet e këtij procesi si dhe standardet kombëtare të kontrollit dhe sigurimit të cilësisë së brendshme në IAL-të shqiptare.</p>

Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Programi MSh në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare ka një strategji zhvillimi e cila është bazuar në analizën, në rang departamenti, mbi ecurinë e programit ndër vite. Departamenti në bashkëpunim me KPSC analizon problematikat e vërejtura mbi programin dhe ndërmer hapat përkatëse. Gjatë vizitës u informuam që në përgjithësi universiteti ka një përjasje konservatore dhe ndryshimet bëhen pas konsultimeve të gjera e të gjata dhe ndryshimet në fakt bëhen rralle. Në fakt, bazuar edhe në RVB, në këtë program nuk ka patur ndryshime kurrikule.</p>
Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>Institucioni është i akredituar në nivel institucional dhe programi gjithashtu duke përmbushur të gjitha kërkesat ligjore në fuqi. Në përgjithësi institucioni përdor instrumentat e duhura për garantimin e cilësisë. Nga sondazhet elektronike e deri tek dëgjimi në klasë, institucioni është i angazhuar fuqimisht për të garantuar cilësinë e mësim-dhënies dhe ofrimin e një eksperience akademike sa më të mirë dhe efikase. Siç u tha edhe më lart ndoshta duhet shtuar elementi i fokus grupeve në matjen e kënaqshmërisë së studentëve për të marrë informacione më të plota dhe të thelluara rreth zhvillimeve brenda auditorit.</p> <p>Në planin strategjik të institucionit ka një seksion të veçantë dedikuar kontrollit të brendshëm të cilësisë që synon përmirësimin e vazhdueshëm të mësim-dhënies e të mësim-nxënies.</p> <p>Gjithashtu, duke qenë se dhe studentët dhe stafi janë të përfshirë në procesin e matjes së brendshme të cilësisë, edhe me sa pamë nga vizita në institucion të dyja palët ishin të informuara mbi këtë proces.</p> <p>Departamenti, programi dhe vetë universiteti kanë strategji zhvillimi (të cilat janë komplemetare) dhe që prekin çeshtje që kanë të bëjnë me kontrollin e brendshëm të cilësisë.</p>
Konkluzionet e vlerësimit:	
<p>1. Nga analiza e dokumentave shkresorë dhe vizita ne terren ishte e qartë se institucioni përdor metodologji vlerësimi për ecurinë e programit të studimit me qëllim identifikimin dhe përmirësimin e problematikave të identifikuara në kohë.</p>	

2. Kontrolli i brendshëm i cilësisë në institucion bëhet rregullisht dhe në mënyrë transparente jo me qëllim ndëshkimin por përmirësimin sistematik të problemeve të mundshme.
3. Të dhënat që dalin nga këto kontrolle analizohen nga KPSC dhe kalohen në instancat përkatëse të cilat i përdorin për të bërë një analizë tërësore të zyrës së tyre dhe për të marrë masa në bazë të rezultateve të analizës së ndërmarrë.

Rekomendim: *Rekomendohet që në të ardhmen, edhe teksa universiteti zgjerohet dhe kontakti individual bëhet më i vështirë, të përfshihen fokus grupet në metodologjitë e vlerësimit të brendshëm të cilësisë.*

Standardet përmbushen

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Objektivi kryesor i programit mbetet pajisja e studenteve me aftësitë e duhura për të analizuar, kuptuar dhe interpretuar institucionet, aktivitetet dhe interesat e aktoreve kryesore në marrëdhëniet ndërkombetare. Programi ka një përmbajtje të gjere tematikash dhe ofron mundësi jo vetëm për të krijuar një bazë solide njohurish por edhe për të specializuar studentet në fusha të marrëdhënieve ndërkombetare për të cilat kanë interes. Programi ofron një ndërthurje lëndesh interdisciplinare duke bashkëruar jo vetëm subjekte nga shkencat politike por edhe nga ajo e ekonomisë ndërkombetare. Duke u bazuar edhe në eksperiencat ndërkombëtare, programi ofron cilësi mësimdhënie që është në standardet dhe nivelet e kërkuara nga arsimit i lartë në Shqipëri.

Organizimi i programit është kryer konform rregullave dhe procedurave ligjore në fuqi si përsa i takon organizimit të programit në vite akademike, semestra, dhe kredite ashtu edhe përsa i takon ngarkesës përkatëse për çdo komponent. Programi ofron edhe një varietet të gjere formash vlerësimi për studentet duke ndërthurur provimet orale me ese, projekte kërkimore apo edhe detyra kurse cka i përgatit studentet në një nivel më të mirë si për tregun e punës ashtu edhe për të rritur kapacitetin e tyre kërkimor për të vazhduar studimet në nivelin e doktoratës, ndërsa i ndihmon studentët “të zhvillojnë aftësitë e të menduarit kritik, të komunikojnë qartë, të kuptojnë dimensionet etike të vendimeve që ata bëjnë, të njohin rolin dhe rëndësinë e menaxhimit efektiv të arsimit në përmirësimin e shoqërisë dhe anëtarëve të saj”.

Programi organizohet në bazë të dy viteve akademike dhe në bazë të sistemit të Bolonjës ofron 120 ECTS (60 ECTS për secilin vit akademik). Vetë programi është i organizuar në bazë të krediteve

ECTS sipas procesit të Bolonjës nga të cilat 84 ECTS përfitohen gjatë lëndëve të përfundimit të lëndëve të parashikuara në planin mësimor dhe 36 ECTS për tezen e diplomës.

Sic thuhet edhe ne RVB (faqe 91), citojme: “Misioni i programit të studimit Master i Shkencave në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare është të mësojë dhe trajnojë ekspertë të ardhshëm të cilët mund të bëjnë hulumtime me cilësi të lartë dhe mund të kontribuojnë në aftësinë zgjidhëse të problemeve të institucioneve politike”.

Universiteti ofron nje baze te mire materiale persa i takon publikimeve dhe aksesit qe studentet kane ne dispozicion ne librarite online por nevojitet nje pune me e kujdesshme per te rritur aksesin e materialeve te kursit online.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Ky program studimi ka filluar në vitin akademik 2011-2012 dhe më pas është akredituar nga Ministria e Arsimit për një periudhë 6-vjeçare. Objektivat kryesore të këtij masteri studimi kanë si qëllim pajisjen e studenteve me njohuritë e nevojshme për të njohur kuptuar dhe interpretuar mënyrën se si funksionojnë institucionet politike në përgjithësi dhe në mënyrë specifike institucionet ndërkombëtare. Ky është një parakusht për të pajisur specialistët e ardhshëm me aftësitë e duhura për të kontribuar në sferën e marrëdhënieve ndërkombëtare si për promovimin e objektivave strategjike (demokratizimi, integrimi në organizatat ndërkombëtare, zhvillimi ndërkombëtar, etj) por edhe për zgjidhjen e ngrerave apo krizave ndërkombëtare. Programi synon të arrijë këto objektivë nepermjet rritjes se cilesise se mesimdhënies dhe aktiviteteve jo-kurrikulare me studentet.

Përveç objektivave të përgjithshme për të takon mesimdhënies dhe punesimit të studenteve, programi paraqet edhe objektivë specifike sic shprehet në dokumentacionin e paraqitur, citojme:

- a) “Të nxisë kërkimin shkencor që kontribuon në shtimin e njohurive në këtë fushë.
- b) Të japë studentëve aftësi për të lidhur shkencën politike dhe marrëdhëniet ndërkombëtare me fusha të tjera të ndërlidhura, si sociologjia, kultura, ekonomia etj.
- c) Të japim në mënyrë specifike njohuri mbi konfliktet lokale dhe globale dhe t'i trajtojmë ato për kapacitetet e menaxhimit të konfliktit”.

Megjithatë mungon një angazhim i programit lidhur me zhvillimin e praktikave mesimore brenda programit. Cilësia e praktikave mesimore duhet të jetë pjesë integrale e objektivave mesimore sepse jo vetëm i pajis studentet me njohuri praktike për mënyrën se si funksionojnë institucionet respektive por edhe krijojnë mundësinë për të rritur perspektivat e punesimit në të ardhmen e afert (pas një praktike të suksesshme mesimore studentet mund të kenë me shumë shanse punesimi sesa kolegët e tyre, të cilët nuk janë të ekspozuar ndaj kësaj eksperience).

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

- 1 vit akademik ka 32 javë mësimore dhe 480 ore në auditor
- 1 Semestër ka 16 javë mësimore dhe 240 ore në auditor

Ne zbatim të legjislacionit në fuqi 1 ECTS ka 25 ore mesimore dhe pune të studentit. Nje ore mesimore ka 60 minuta ndersa viti akademik eshte i organizuar ne ECTS dhe ka 60 te tilla. Programi i paraqitur per akreditim ka 120 ECTS, nder te cilat 84 jane caktuar per lendet mesimore dhe 36 ECTS jane rezervuar per tezen kerkimore.

Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë (Tabela 7 e Planit në aneks)

Plani mësimor brenda një cikli të programit është ndarë në dy vite akademike me nga 60 ECTS secili prej tyre, për një total prej 120 ECTS. Ngarkesa e çdo lënde është shprehur në numrin e orëve dhe vlerën respektive në ECTS. Organizimi i moduleve të ofruara është bërë në bazë të raportit orë mësimi ECTS. Orët e mësimi janë të ndara në auditor, seminare dhe punë e pavarur e studentëve (ndërkohë që këtu llogariten edhe orët e shkrimit të tezës së diplomës). Në përgjithësi, në të gjitha vitet e marra në shqyrtim, dhe në të gjitha modulet, ka një shpërndarje orësh e cila favorizon punën e pavarur të studentit (projekteve në grup apo eseve individuale) në krahasim me orët në auditor, i cili në modulet dhe vitet e paraqitura qëndron në shkallën 1:2 në favor të punës së pavarur të studentit. Mënyra kryesore e vlerësimit të studentëve është provimi, ndonëse në disa prej moduleve parashihen edhe mënyra të tjera integruese siç janë projektet kërkimore apo puna në grup si pjesë e vlerësimit përfundimtar.

Ne tabelen 25 të paraqitur në RVB janë nenvizuar lëndet me zgjedhje, të cilat janë të larmishme dhe ky është një aspekt pozitiv i programit, ndërkohë që semesternin e parë dhe të dytë nuk sqarohen lëndet me detyrim.

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

- Për leksionet 48 orë në auditor dhe 102 orë punë e pavarur e studentit
- Për Seminaret 48 orë në auditor dhe 102 orë punë e pavarur e studentit

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara

Nuk ka pasur ndryshime në planin mësimor

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës (Tabela ne Aneks)

Duke u mbështetur në planet mësimore të paraqitura, sic e kemi theksuar edhe me lart, ne te gjithë vitet akademike, per periudhen e akreditimit te marre ne shqyrtim, lendet jane ofruar pothuajse te gjitha nga PAE.

Për vitin 2017-2018: 44 (ofrohet nje numer i larte lendesh me zgjedhje) lëndë janë ofruar nga PAE, dhe asnje lëndë nuk eshte ofruar nga PAK.

Për vitin 2016-2017: 43 lëndë janë ofruar nga PAE, 1 lëndë janë ofruar nga PAK.

Për vitin 2015-2016: te gjitha lendët janë ofruar nga PAE.

Për vitin 2014-2015: te gjitha lendët janë ofruar nga PAE.

Për vitin 2013-2014: te gjitha lendët janë ofruar nga PAE.

Për vitin 2012-2013: te gjitha lendët janë ofruar nga PAE.

Ne kete tabele, sic eshte vene ne dukje edhe me lart, bie ne sy fakti se te gjithë lendet jane ofruar nga PAE dhe nuk ka PAK. Sic e kemi theksuar edhe me siper kjo metodologji ka anet e saj pozitive por edhe mund te influencoje ne planin afatgjate ne ngurtesimin e tematikave te programit dhe mungesen e fleksibilitetit apo nevojës per ndryshim. Pozitiv eshte fakti se ofrohet nje kurrikulum inter-disiplinar duke bashkerenduar programin me PAE nga fakultete te tjera (sic eshte ai Ekonomik) por edhe nga departamente te tjera brenda fakultetit (per tematikat qe kane te bejne me te drejten nderkombetare).

Megjithese disa prej lendeve, ne nje grup lendesh ku bejne pjese Rritja dhe Zhvillimi 1 dhe 2 apo edhe Kretiviteti dhe Reklama, mund te jene me zgjedhje, perseri duhen sqaruar me mire qe ne titull per te deshmuar qarte lidhjen me programin ku bejne pjese (ne rastin tone Shkenca Politike dhe Marredhenie Nderkombetare). Ndryshe eshte e veshtire per studentin qe ne morine e lendeve me zgjedhjeve (te cilat ofrohen ne nje numer te larte dhe ky eshte nje tjetër aspekt pozitiv) te zgjedhe lendet e pershtashme. Kjo behet edhe me e rendesishme pasi ne anekset e syllabus te paraqitur nuk ka nje ndarje ne baze programesh dhe eshte nje dokument i cili ne me shume se 97 faqe jep informacione per te gjithë modulet (cka e ben punen e studentit ne perzgjedhje edhe me te veshtire).

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studentin për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS

- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Aneksi dhe informacioni i paraqitur nga Epoka, permban te gjitha informacionet e kerkuara ne pikat e mesiperme, dhe vecanerisht lidhur me “Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit” dhe “Njohuritë paraprake që duhet të ketë studentit për përvetsimin e lëndës”, te cilat jane permbledhur ne Ankesin 5 Silabus i Programit te Studimit.

Analizë e cilësisë së syllabuseve

Tematikat e programi te ofruar kane disa avantazhe sic jane larmia e temave qe mbulojne me ane te nje metodologjie inter-disiplinare (faktor kyc ne nje master sic jane marredheniet nderkombetare) por edhe sasite e tematikave duke krijuar mundesine e nje zgjedhjeje sa me te gjere e cila i vihet ne dispozicion studenteve.

Megjithate mund te ofrohen edhe disa sugjerime:

- Kemi nje numer te kufizuar lendesh te tipi A. Ofrohen vetem 3 lende nga te cilat studentet duhet te zgjedhin 2 per nje total pre 12 ECTS. Kjo nenkupton qe studentet kane njohuri fillestare mjaft solide dhe te plota. Por ky nuk mund te jete gjithmone rasti pasi ne nje program te tille inter-disiplinar studentet mund vijne nga profile te ndryshme sic jane per shembull fakulteti ekonomik apo juridik dhe kane nevojte per me shume lende formuese per te krijuar bazen e nevojshme te cilen e kane studente te cilat kane nje bachelor ne marredhenie nderkombetare apo studime nderkombetare. Per me tej nje numer i ulet lendesh formuese, mund te pengoje edhe rritjen e numrit te studenteve qe vijne nga disiplina te ngjashme por nga universitete te tjera, te cilat mund te mos kene patur nje program kaq te gjere gjate ciklit bachelor. Prandaj edhe eshte praktike e aplikuar kurdo qe te kete nje numer te kenaqshem lendesh formuese keshtu qe studentet arrijne te krijojne nje balancim njohurish ne fillim te programit. Ofrimi i lendeve me zgjedhje ne kete rast do te ishte nje alternative per ata studente qe i kane keto njohuri (ndonese kalimi ne nivelin master kerkon nje sere njohurish te cilat nuk jane te njejta me ato te nivelit bachelor).
- Ne lendet formuese jane ofruar dy module ne te cilat studentit duhet te zgjedhe njerën prej tyre: Teorite Politke ne Marredheniet Nderkombetare ose Politika Publike Europiane. Keto dy module nuk jane te barazvlefshme si persa i takon rendesise ashtu edhe nivelit te njohurive. I pari eshte nje gur themeltar ne zhvillimin e metejshe akademik te studenteve dhe nje celes hyres per te kuptuar logjiken e vendimarrjes apo aksioneve te institucioneve nderkombetare dhe shteteve. Moduli i dyte eshte pikerisht nje politike qe eshte rezultat i ketyre logjikave. Pra

nuk kemi te bejme me dy module te krahasueshme. Politikat publike te BE ndonese jane mjaft te rendesishme duhet ti perkasin tipologjise B pasi nuk mund te kete siguri se studentet njohin jo vetem aspektin teorik te politikave nderkombetare por edhe vete ndertimin, funksionimin dhe objektivat e BE.

- Ne tipologjine B jane propozuar rreth 29 module me nga 6 ECTS secili per nje total prej 156 ECTS nderkohe qe studentet duhet te zgjedhin vetem 48 ECTS. Nje variacion kaq e i gjere zgjedhjeje krijon mundesine qe studentet te bejne nje mono-disciplinare aq me teper kur nuk ka nje grupim te sakte te dy ose me shume moduleve qe perbejne nje grup tematikash dhe nga te cilat duhet te perzgjidhen lendet e tipit B.
- Ka nje ndarje te politikave publike te BE dhe disa jane akomoduar ne kategorine B dhe disa ne C. Duke pranuar faktin se politikat publike te BE-se jane njelloj te rendesishme duke qene se i drejtohen stakeholders te ndryshem, lind pyetja pse eshte bere nje ndarje e tille.
- Nuk ka nje logjike te qarte te ndarjes se lendeve ne grupet B dhe C. Per shembull, per vete prioritetet e vendit por edhe me gjere, politikat ekonomike integruese te BE-se mund ti perkasin grupit B ndersa Etika ne Periudhen e Globalizimit grupit C.
- Ne pergjithesi, mendojme se duhet patur me shume kujdes ne akomodimin e moduleve te ofruara ndermjet vitit te pare dhe te dyte te programit, duke i dhene perparesi ne vitin e pare lendeve formuese dhe themelore ne kete fushe, duke i ofruar studenteve mundesine per tu specializuar me tej ne nje ose disa fusha specifike gjate studimit te vitit te dyte.
- Nje tjetër pyetje lind per lendet e grupit E ne te cilat nuk ofrohet asnje kredit apo modul. Duke marre te mireqene faktin se niveli i gjuhes angleze nuk eshte nje sfide per studentet e ketij programi, aspekte te tjera sic jane lendet informatike apo stazhi dhe praktika mesimore luajne rol ne formimin e studentit prandaj nuk mund te perjashtohen plotesisht.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

➤ Tabela e përditësuar e planit mësimor

➤ Tabela e stafit akademik të lidhur me programin e studimit për dy vitet e fundit akademike

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS); Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është	Ne perputhje me te dhenat e paraqitura dhe informacionin e prezantuar dhe prezantimit të programeve mësimore për të gjithë periudhën e akreditimit, programet e studimit janë të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Në bazë të informacionit të prezantuar dhe

60 kredite;	prezantimit të programeve mësimore për të gjithë periudhën e akreditimit, një student që ndjek programin me kohë të plotë mund të grumbullojë gjatë një viti mesatarisht 60 kredite.
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p>Kriteri 7 Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Programi i paraqitur ofron një larmi modulesh të cilat thellojnë me tej njohuritë e marra në nivelin bachelor jo vetëm përsa i takon thellimit të njohurive të marra me pare por edhe ofrimin e moduleve baze apo specializimit në tematike të caktuara. Organizimi i moduleve me detyra kurse, përgatitje prezantimesh, projekte në grup, ese individuale apo aktiviteteve të brain-storm gërsheton edhe aspektin praktik të programit. Më shumë mbetet për tu bërë në këtë drejtim për institucionlizimin e mundësive për kryerjen e praktikës së programit pranë institucioneve apo organizmave të specializuara në këtë drejtim.</p> <p>Kurrikula e paraqitur, trajtimi i tematikave në syllabus dhe metodologjia interdisiplinare, apo ofrimi i të gjithë programit në gjuhën angleze, deshmohen synimet e programit për të zgjeruar me tej njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve.</p> <p>Programi i ofron studenteve përveç lendeve të specializuara edhe soft-skills apo aftësi trasversale sic janë shkrim/lexim akademik, kompetenca në mendimin kritik apo edhe në zgjidhjen e problemeve. Vendosija moduleve për metodat e kërkimit shkencor si edhe mjaft aspekte të punës që i kërkohet të bëjnë studentëve brenda kursit por edhe në punën për përgatitjen e tezës së masterit, i pajis studentët me mjetet e nevojshme metodologjike për të vazhduar më tej në karrierën akademike</p> <p>Programi ofron njohuri të qëndrueshme si në aspektin e tematikave ashtu edhe në aspektin teorik të politikave të marrëdhënieve ndërkombetare dhe rrymave kryesore të cilat analizojnë sjelljen e institucioneve dhe organizatave në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Me tej programi përveçse analizon edhe politika publike dhe ato të integritimit ofron edhe një kurs të vecantë për shkrimin dhe leximin akademik. Këto njohuri krijojnë një bazë solide për të vazhduar me tej në ciklin e tretë të studimeve.</p>
Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshatje me nivelin e studimeve.	
Kriteri 1 Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e	Programi i paraqitur ka një renditje të qartë të objektivave, të përgjithshme dhe specifike, duke ndërtuar jo vetëm modulet por edhe strukturat

<p>studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p>Kriteri 2 Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>institucionale të nevojshme për arritjen e këtyre objektivave. Kjo ka sjelle një përputhje ndërmjet objektivave dhe nivelit akademik të studimeve që ofrohen. Kriteri përmbushet nga ana e tematikave studimore por në objektivat e programit në të ardhmen duhet të shtohet edhe një ekuilibrim me të mirë të lendeve të detyruara dhe atyre me zgjedhje si edhe përfshirja e praktikës mësimore në programin e masterit.</p> <p>Vihet re një larmi formash vlerësimi në program. Përveç provimeve ka edhe vlerësime të ndërmjetme siç janë detyra e kursit, prezantimet, projekte, apo edhe duke harmonizuar në këto mënyra komunikimin oral dhe atë me shkrim (mjaft i rëndësishëm në ditët e sotme). Fakti se çdo pedagog mund të hartojë vetë format e vlerësimit, siç mesuam në takimin me përgjegjës të departamentit gjatë vizitës në institucion, ndihmon këto larmi dhe e bën vlerësimin jo vetëm me objektiv por edhe me interaktiv për studentin.</p>
--	--

Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikën e mira të vendeve europiane;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Nga vlerësimi i kurrikulumit dhe nga organizimi i silabus (Aneksi 5), nga botimet e PAE dhe CV (ku bie në sy eksperiencat në universitete jashtë vendit) e tyre mund të thuhet se programi shfrytëzon eksperiencën e pedagogëve të tij për të ofruar një bazë njohurish të zhvilluar ndër vete si pranë këtij institucioni ashtu edhe institucioneve të huaja.</p> <p>Nga studimi i moduleve të ofruara, silabus, kushteve të pranimit të studentëve (siç është gjuha angleze e detyruar për tu pranuar në program) dhe formave të vlerësimit, larmia e tematikave që mbulojnë sidomos nga lëndet me zgjedhje, harmonizimi interdisiplinar i tre disiplinave kryesore (shkenca politike, ekonomike dhe juridike) mund të themi se ky program mund të jetë konkurrues edhe jashtë vendit.</p> <p>Lidhur me faktin nëse programi i studimeve është hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuara në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, informacioni i paraqitur nuk ofron të dhëna lidhur me këtë aspekt ndonëse informacionet e ofruara në të tjera seksione të vlerësimit dhe dokumentat e bashkëngjitura tregojnë se lidhur me aspektet formale, programi është hartuar në përgjithësi në përputhje me legjislacionin dhe direktivat e BE-së.</p>
---	--

Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të</p>	<p>Programi ofron mundësi që përveç njohurive baze të ofruara në lëndet formuese të kënaqëse edhe aktivitete siç janë ese individuale, nxitjen e mendimit kritik, apo projekte në grup, të cilat stimulojnë dhe aftësojnë studentet edhe në fushën e kërkimit shkencor. Programi akademik megjithatë duhet të hartohet me mirë me zbatimin praktik nëpërmjet praktikës</p>
---	--

<p>Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p>Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>profesionale pasi aplikimi i këtij koncepti gjatë programit mundëson përgatitjen me të mirë të studentëve jo vetëm në aspektin e kërkimit shkencor por edhe për kërkesat e tregut të punës.</p> <p>Programi i marrë në shqyrtim është hartuar në përputhje me ligjet dhe dispozitat në fuqi të Ministrisë së Arsimit. Një argumentim me i plotë i hartimit të tij në përputhje me strategjinë e zhvillimit të IAL është shpjeguar në strategjinë e IAL për periudhën 2018-2022, dhe në strategjinë e departamentit për periudhën 2017-2022.</p> <p>Nga një vëzhgim i listës së publikimeve të pedagoqeve të programit dhe moduleve që ato drejtojnë në këtë program, vihet re një përputhje e kënaqshme. Politika që ndjek IAL për promovimin e punës shkencore edhe me anë të financimeve ndihmon vecanerisht në këtë drejtim. Kështu për periudhën e akreditimit të programit 2012-2018 në nivel fakulteti (ku bëjnë pjesë programi) janë botuar mbi 64 artikuj në organe shkencore ndërkombëtare, ndërsa pedagoget që kontribuojnë në zbatimin e programit në fjalë kanë mbajtur peshën e më shumë se 70% të këtyre botimeve (shih për më shumë link me info të detajuara: http://flss.epoka.edu.al/neës-faculty-publications-list-3720.html). Ky nivel relativisht i lartë i publikimeve nga ana e personelit akademik në revistat e huaja dhe ato të specializuara. Kjo stimulohet edhe nga organizimi i pedagoqeve në grupe të caktuara studimore cka rrit efikasitetin e publikimeve dhe specializimin e tyre.</p> <p>Për të rritur më tej nivelin e punës kërkimore të personelit akademik, pedagoget janë angazhuar në grupe të veçanta kërkimore që janë formuar në Departamentin e Shkencave Politike dhe Marrëdhënies Ndërkombëtare. Fushat e grupeve ekzistuese të hulumtimit kanë të bëjnë me objektivat e programit të studimit Master në Shkencën Politike dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare i.e.</p> <p>Perceptimet Politike dhe Pjesëmarrja e Studenteve Universitare në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni; Situata e demokracisë i situatës së demokracisë në vendet e Ballkanit Perëndimor; Impakti i Kondicionalitetit të BE mbi vendet e Ballkanit Perëndimor; Edukimi mbi paqen dhe transformimin e konflikteve në Ballkan; Dy vende 4 shtete: Krahësimi ndërmjet Austrisë dhe Gjermanisë dhe Kosovës dhe Shqipërisë; Progresi i Shqipërisë lidhur me Objektivat e Zhvillimit të Mijevjeçarit dhe Zhvillimi Sostëmbël: fokusi mbi femijet.</p> <p>Shih edhe: (http://Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënies Ndërkombëtare.epoka.edu.al/home-research-areas)</p>
--	--

	344-1803.html).
Standardi I.7 - Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	Kriteret nuk aplikohen për këtë program
Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Ka një studim si në nivel universiteti ashtu edhe programi lidhur me kërkesat e tregut të punës. Dokumenti i cili analizon në një mënyrë të përgjithshme kërkesat e tregut të punës por nuk është një studim i dedikuar për këtë program. Vetëm përciptas citohen nevojat e paraqitura nga institucionet qëndrore ku theksohet se pothuajse gjysma e nëpunësve nuk kanë arsimin e nevojshëm, në profilin e këtij masteri. Megjithatë fakti që 90% e studenteve të diplomuar janë punësuar (shih RVB faqe 15) janë qartësisht një aspekt pozitiv, që dëshmon vlerën e këtij programi përballë konkurrencës ndërsa nuk behet një analizë e konkurrenteve në tregun e edukimit (ndonese numri i studenteve të diplomuar është akoma i vogël).</p> <p>IAL zhvillon përpara hapjes së një programi studimi, një studim mbi nevojat e tregut për çdo program të ciklit të dytë që ofron, siç kërkohet nga procesi i akreditimit, kryen. I njëjti studim i dorëzohet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe ASCAL-it në kohën e aplikimit për licencim dhe akreditim të programit të studimit.</p>
Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Lidhur me impaktin e programit të ofruar në interesat kombëtare mund të them që nga vizita në institucion (takimi me përgjegjësin e departamentit dhe stafin akademik) si edhe nga diskutimi me studentet nuk u konstatua asnjë element në këtë program studimit që shkonte kundër interesave kombëtare.</p> <p>Vendosja e impaktit në komunitet dhe në zhvillimin e vendit si një nga objektivat kryesore të universitetit si dhe fushat akademike të studimit me një interes të dukshëm në analizën e pozitës gjeopolitike të vendit dhe procesit të integritetit të Shqipërisë dëshmojnë se programi synon ruajtjen e vlerave kombëtare në përgjithësi dhe atyre kulturore në veçanti.</p>
Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.	

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve “Master i Shkencave” realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;</p>	<p>Programi i studimeve Master i Shkencave në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare realizohet me 120 ECTS, duke përfshirë 30 ECTS për çdo semestër dhe për tezën, e cila vlerësohet me 36 ECTS, e përgatitur në semestrin e katërt. Kohëzgjatja e studimeve Master i Shkencave në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare është 2 vite akademike.</p>
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve “Master Profesional” realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.</p>	<p>Kriteri nuk aplikohet për këtë program studimi</p>
<p>Kriteri 3 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës “Master i Shkencave”. Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).</p>	<p>Kriteri nuk aplikohet për këtë program studimi</p>
<p>Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;</p> <p>Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p>	<p>Informacioni i ofruar është lehtësisht i konsultueshem për ata që kanë nevojë për njohuri të përgjithshme, por është e vështirë gjetja online e programit të studimit dhe silabusit të programit.</p> <p>Ofrimi i dokumentacionit për këto akreditime tregon se programet e studimit dhe syllabuset ofrohen në për studentet janë të konsultueshme në versionin e tyre elektronik.</p>
<p>Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.</p>	
<p>Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;</p> <p>Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.</p>	<p>Plani mesimor i prezantuar në program është i qartë dhe organizimi i ngarkesës mesimore krijon mundësi për diplomimin e studentit brenda afatit të parashikuar.</p> <p>Në programin e paraqitur janë parashikuar 36 kredite për realizimin e tezës.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Pjesa më e madhe e kriterëve plotësohen tërësisht falë një programi mesimor që ofron një metodologji multi-disiplinare dhe një larmi të gjërë tematikash. 2. Procedurat dhe strukturat në dispozicion të programit mundësojnë një nivel të mirë cilësor në mesimdhënie por edhe kërkimin shkencor dhe publikimet e pedagogëve. 3. Organizimi i tematikave duhet të rishihet duke patur parasysh disa sugjerime si për ata që kanë nevojë për njohuri të përgjithshme, por edhe vendosjes në kohë (në vitin e parë ose të dytë të programit). Modulet C dhe D duhet të rishihen për të patur një produkt më të mirë edhe në këto drejtim. 	

4. Ka një disbalancë midis lëndëve formuese dhe atyre cilësuese në favor të të dytës.
5. Nje studim me i kujdesshem i nevojave te tregut te punes dhe orientimit konform tyre i programeve mesimore, ndonese niveli 90% i punesimit te te diplomuarve eshte nje hap shume pozitiv.

Rekomandim: *Te shikohet mundësia e balancimit me te mire te lendeve formuese dhe atyre cilesese simdomos ne vitin e pare te programit.*

Standartet përmbushen kryesisht

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Mësimi në programin e studimit zhvillohet pasditeve të javes për t'i dhënë mundësi edhe studentëve të punësuar që të ndjekin lirisht leksionet. Normalisht një lëndë zgjat 3 orë por kishte disa që zgjasin edhe katër orë. Është në dorë të lektorit për të bërë ndarjen midis leksioneve dhe seminareve gjatë 3 ose 4 orëshit që është në dispozicion të lëndës së tij. Normalisht leksionet zhvillohen më metoda interaktive dhe duke u bazuar edhe në mundësitë teknologjike që ofron universiteti. Duke qenë se programi është i vogël numri i studentëve në klasë është ideal për të bërë punë në grup dhe për t'i dhënë vëmendje individuale studentit. Përgjethësisht në leksione dhe seminare përdoren 'case studies' dhe metoda të tjera ku studentit është drejtues aktiv i procesit mësimor dhe mëson duke bërë e duke qenë mendues kritik në klasë. Kontrolli i njohurivë bëhet më disa mjete të ndryshme si pjesëmarrja në klasë, detyra të shkurtra të përjavshme që të incentivizojnë studentin të vij i përgatitur në klasë, me ese të gjata, me projekte në grup si dhe me provimin përfundimtar. Normalisht vlerësimi është i shpërndarë gjatë gjithë semestrit për t'i dhënë mundësi studentit që të jetë aktiv gjatë një periudhe sa më të gjatë.

Nga biseda që patëm me studentët ishte e qartë se ato ishin shumë të kënaqur me metodat e mësimdhënies që aplikoheshin në këtë program dhe me lirinë që i jepej atyre për të qenë aktiv në klasë. Në mënyrë të veçantë ato vlerësuan punën në grupe, projektet e ndryshme që bënin dhe sidomos aktivitetet në klasë që i mundësonin aplikimin praktik të koncepteve teorike që përftonin në leksion.

Mësim-dhënia vlerësohej dhe kontrollohej nga departamenti në bashkëpunim të ngushtë më KPSC të cilët siguroheshin që standartet e mësim-dhënies të ishin në linjë me kërkesat ligjore dhe zhvillimet bashkë-kohore të didaktikës mesimore. Për këtë, përveç kontroleve të herë-pas-hershme, institucioni zhvillon edhe trajnime me trajnues të brendshëm ose të jashtëm për të rritur nivelin dhe metodikën e mësim-dhënies në institucion.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet (Tabela ne aneks):

- Leksione
- Seminare
- Ushtrime
- Laboratore
- Detyre
- Praktikë lëndore
- Praktikë profesionale
- Etj

Format e kontrollit të njohurive

Institucioni vë vazhdimisht theksin ne kombinimin e praktikave të kontrollit të njohurive të studentëve që ndjekin këtë program. Siç u tha edhe më lart vlerësimi është i shpërndarë në tërësinë e semestrit për të akomoduar sa më shumë stile të të mësuarit, për të incentivizuar studentët të përgatiten jo vetëm në fund si dhe për të ‘prodhuar’ studentë më etikë te fortë pune dhe aftësi për t’u integruar lehtësisht në tregun e punës. Bazuar në RVB-në e programit por edhe nga bisedat që patëm në institucion, vlerësimi ishte i ndarë dhe i shpërndarë në mënyrë të arsyeshme sipas këtij rregulli. Pjesëmarrja na klasë 10% e notës, përmbushja e detyrave të shkurtra gjatë semestrit 10% e notës, testim gjatë vitit (midterm) 30% e notës dhe provimi përfundimtar 50% e notës. Kjo praktikë i rrit mundësitë e studentëve për të qenë të suksesshëm, rrit dëshirën e tyre për t’u përgatitur në vazhdimësi, dhe i mundëson pedagogut që të vlerësojë në kohë reale se ku po çalon klasa dhe cilat praktika didaktike janë më efektive se të tjerat.

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

Njësia bazë që ofron programin ishte aktive në aktivizimin e studentëve të programit MSH në aktivitetet e saj kërkimore, administrative, dhe mësimore. Univesiteti ndiqte praktikën e përfshirjes së studentëve të MSH si ‘teaching assistants’ për të ndihmuar pedagogët në procesin mbështetës mësimor. Kjo ishte edhe një mënyrë e mirë për t’i dhënë studentëve eksperiencë pune por edhe për të kuptuar nëse akademia ishte nje rrugë që atyre i pëlqente të përfshiheshin në të ardhmen. Gjithashtu studentët përfshiheshin, sipas mundësive dhe aftësive, në projekte kërkimore të pedagogëve, në projekte kërkimore të fituara nga institucioni si në rang departamenti ashtu edhe në rang institucioni. Që nga akreditimi i mëparshëm, institucioni ka përfshirë 9 studentë të programit në projekte kërkimore individuale të pedagogëve, 4 studentë në projekte kërkimore në rang departamenti, dhe 4 studentë në projekte kërkimore në rang fakulteti. Duke patur parasysh se ky program ka me nr të vogël studentësh, pjesëmarrja e tyre në projekte kërkimore është e lartë dhe e cila tregon se institucioni e ka

një politikë të tijën efektive për përfshirjen e studentëve të programit MSH në jetën e departamentit dhe aktivitetit të tij shkencor.

9. Studentët

Pjesa përshkimore

Universiteti Epoka promovon aktivisht programin e MSh në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare (ShPMN) nëpërmjet takimeve me studentët maturantë, studentët e ciklit baçelor, dhe faqes së saj online. Studentët e interesuar në këtë program aplikojnë online nëpërmjet informacionit të marrë në faqen <http://pir.epoka.edu.al/home-political-science-int-relations-359-1993.html> dhe më pas dorëzojnë dokumentacionin përkatës në institucion. Nga takimi në institucion u vu re se procedurat ishin transparente, të shpejta dhe profesionale. Departamenti kishte personel specifik të cilët mbulonin aplikimet e reja dhe i përgjigjeshin pyetjeve që mund të kishin aplikantët në kohë reale. Gjithashtu institucioni na informoi që bëhej kujdes i veçantë që të respektoheshin afatet kohore dhe ligjore të vendosura nga Ministria e Arsimit për regjistrimin e studentëve të rinj.

Programi kishte një numër të kufizuar studentësh që do të thotë se numri i diplomantëve është relativisht i ulët por cilësia e studentëve si në hyrje ashtu edhe në dalje (siç do të bëhet e qartë më poshtë) ishte e kënaqëshme. Nga takimet me studentët u vu re se ato ishin të mirë-informuar mbi kohë-zgjatjen e studimeve, praktikat profesionale që mund dhe duhej të bënin, procedurat e diplomimit e me rradhë. Edhe komunikimi me ish-studentët ishte aktiv nëpërmjet zyrës së Alumni e cila mblidhte dhe përpunonte informacion mbi vazhdimësinë e studentëve sidomos përsa i përket punësimit dhe aksesit të tyre në tregun e punës.

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

- Procedurat e pranimit të studentëve

Studentët aplikues aplikojnë përmes faqes Web të Epokës, si dhe dorëzojnë dokumentacionin e nevojshëm në institucion. Më pas, Zyra e Pranimeve përcjell dosjen e aplikuesit tek Departamenti i ShPMN ku Komisioni Shkencor i Departamentit/programit të ShPMN vlerëson aplikimet dhe vendos në bazë të dokumentave të dorëzuar dhe intervistave të zhvilluara. Pasi merret vendimi ai i dërgohet Zyrës së Pranimit e cila më pas ia komunikon aplikuesit. Në fund aplikuesit e pranuar vazhdojnë me regjistrimin në program në Zyrën e Sekretarisë ku midis studentit dhe Universitetit Epoka nënshkruhet një kontratë regjistrimi ku specifikohet kohë-zgjatja e programit, titulli që do të marrë studenti në

momentin e diplomimit, pagesën totale të programit, si dhe procedurat që ndiqen nga studenti në rastet kur kontrata përfundon.

Për t'u pranuar ne programin e MSh në ShPMN studentët duhet të përmbushin kushtet e mëposhtme:

- Të kanë një diplomë Bachelor apo diplomë ekuivalente në disiplinat e përcaktuara nga Komisioni Shkencor i Departamentit përkatës bazuar në kërkesat e ligjit për arsimin e lartë 80/2015;
- Një minimum të mesatares prej 2.00 nga 4.00, për studentët që kanë përfunduar studimet Bachelor në Universitetin Epoka, ose 6.00 nga 10.00, ose mesatare ekuivalente për studentët që kanë përfunduar programet e studimeve Bachelor në Institucione të tjera të Arsimit të Lartë;
- Njohuri të gjuhës angleze në nivelin B1, sipas CEFR, në një nga provimet e mëposhtme; Cambridge, IELTS, TOEFL Internet-based Test (iBT), TOEFL Paper-based Test (ITP), TOEIC, GESE, APTIS.
- Aplikuesit që plotësojnë kriteret e mësipërme duhet të dorëzojnë dokumentat për të përfunduar regjistrimin e tyre në Universitetin Epoka

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Cilësia e studentëve në hyrje të programit ka qenë relativisht e kënaqëshme duke patur parasysh edhe numrin e studentëve të regjistruar. Mesatarja e studentëve në hyrje, sipas raportimit në RVB, është rreth 2.7 nga 4.

Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare

Në këtë program janë regjistruar gjithsej **54 studentë** dhe janë diplomuar gjithësej **20 studentë**. Nota mesatare e tyre në diplomim është **3.4 nga 4.0**.

Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare

9 studentë janë diplomuar në vitin e fundit pa vite përsëritëse.

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Nga të dhënat që na ofroi institucioni ka patur **5 studentë** të transferuar në këtë program.

Të dhëna për punësimin e studentëve

Bazuar në statistikat ekzistuese të marra nga Zyra e Planifikimit të Karrierës e Universitetit “Epoka” është konkluduar që 73% e të diplomuarve nga programi i studimit Master i Shkencave në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare janë të punësuar, 4% të papunë dhe për 23% të të diplomuarve nuk ka informacion rreth vazhdimësisë së tyre.

Numri total të diplomuarve

20 studentë të diplomuar

Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)

15 studentë të punësuar në lidhje me diplomën

Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)

3 studentë të punësuar jo në përputhje me diplomën

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;	Kriteri i parë plotësohet pasi të gjithë studentët e regjistruar në program kishin të paktën një diplomë bachelor me 180 ECTS.
Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;	Edhe kriteri i dytë plotësohet pasi studentët e pranuar në program ishin pranuar konform kërkesave ligjore dhe kishin dosje të plotë në institucion që u kontrollua edhe gjatë vitiztës në institucion. Studentët gjithashtu plotësonin kushtet e pranimit të institucionit që kishte të njëjtat kushte me kërkesat ligjore.
Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;	Në bazë të kërkesave ligjore, por edhe duke patur parasysh se mësim-dhënia në Epoka zhvillohet në gjuhën angleze, studentët e kishin detyruesë dhënien e provimit të anglishtes si kusht paraprak për pranimin në program.
Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit	Nga takimi që patëm në institucion u vu re

<p>European të Gjuhëve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kritereve të pranimit.</p>	<p>se institucioni ishte i ndjeshëm ndaj cilësisë së studentëve që pranon dhe nevojës që herë-pas-herë standardet të rifreskohen dhe të adaptohen me prioritetet e universitetit dhe realitetet e arsimit të lartë në vend. Këto praktika janë reflektuar dhe kodifikuar në strategjinë e re të universitetit si dhe në strategjinë e departamentit dhe programit.</p>
<p>Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>Studentët e programit të studimeve MSh ShPMN nxiten të zhvillojnë trajnime dhe internshipe në institucione të ndryshme në vend dhe jashtë vendit. Epoka gjithashtu organizon çdo vit Panairin e Karrierës, duke i dhënë studentëve mundësi të orientohen për një karrierë të suksesshme. Gjithashtu studentët kanë edhe një mentor që i ndihmon akademikisht si dhe për të krijuar kontakte me tregun e punës.</p> <p>Nga takimi që patëm me studentët ato u treguan mjaft të kenaqur me informacionin që kishin për akreditimin e programit dhe vlefshmërinë e diplomës së tyre.</p> <p>Në mënyrë specifike Epoka kishte një zyrë për këshillimin e karrierës që organizonte internshipet dhe eksperiencat e tjera profesionale të studentëve. Studentët u shprehën të kënaqur me shërbimin që merrnin nga kjo zyrë.</p>
<p>Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>Institucioni disponon statistika të tilla të cilat ishin të qarta dhe të lehta për tu lexuar dhe aksesuar. Këto të dhëna u vunë në dispozicion të grupit të vlerësimit nëpërmjet RVB-së së programit.</p> <p>Institucioni gjithashtu dispononte statistika vjetore për numrin e studentëve të ciklit të dytë. Këto statistika përditësoheshin në mënyrë kapilare që informacioni të ishte i besueshëm dhe i përdorshëm për të gjitha zyrat që nga sekretaria deri tek alumni.</p> <p>Gjithashtu institucioni disponon të dhëna për ecurine e studentëve gjatë programit. Këto të dhëna na u vunë në dispozicion nëpërmjet RVB-së.</p>

Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.

Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;

Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.

Institucioni, nëpërmjet zyrës së alumni dhe kujdesit ndaj studentit disponon një dataset të tillë. Nga takimi në terren u informuam që kjo listë përditësohej çdo gjashtë muaj me të diplomurit e rinj të cilët kontaktoheshin periodikisht për të marrë info mbi statusin e tyre të punësimit. Gjatë takimit nuk u diskutua në detaj nëse institucioni mban listë për studentët që vazhdojnë cikle të tjera studimit, por duke qenë se dhe ato kontaktohen, sit ë diplomuarit e tjerë nga zyra alumni, të dhënat e tyre janë në datasetin e përgjithshëm të statusit të punësimit të studentëve të diplomuar të institucionit.

Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.

Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;

Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;

Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.

Ky lloj informacioni ofrohej që nga momenti që studenti kontaktonte institucionin me dëshirë apo interes për t'u regjistruar. Këto të dhëna gjithashtu reflektoheshin edhe në kontratën e firmosur nga student me institucionin. Edhe nga takimi me studentët u vu re se ata ishin të mirë informuar mbi afatin e përfundimit të studimeve si dhe organizimin e programit të tyre.

Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.

Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;

Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.

Me sa u vu re edhe nga RVB edhe nga vizita në institucion dhe takimi me studentët, një nga pikat e forta të prograit është qëndrimi afër me studentin duke ndjekur të gjithë ecurinë e tyre si nga departamenti, zyra për këshillimin e karrierës që merret dhe me internshipet si dhe zyra alumni pasi ato diplomohen. Ndërsa përsa i përket problematikave me karakter mësimor, departamenti, edhe nëpërmjet mentorëve, i zgjidhte problemet në kohë dhe më cilësi.

Nëpërmjet zyrës së karrierës institucioni i mundësonte studentëve që të bënin internship të ndryshme por jo në formë tradicionale të praktikës mësimore. Internshipet në vetvete ishin positive dhe me ndihme, sic na u tha edhe nga studentët, por në të ardhmen ato duhen adaptuar më mire me kërkesat ligjore të praktikës profesionale.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Institucioni mban të dhëna të plota dhe të sakta mbi studentët që ndjekin programin duke përfshirë dosjen e tyre, informacion mbi ecurinë e tyre akademike, si dhe progresin e tyre në punësim pas diplomimit.
2. Institucioni i ofron studentëve informacion të plotë mbi programin e tyre të studimit, afatet e diplomimit si dhe të gjitha kërkesat e tjera ligjore dhe akademike që ato duhet të përmbushin.
3. Institucioni gjithashtu i ofron studentëve mundësi të mira për të bërë internshipe. Gjithësesi këto internshipe, nëse përdoren për të zëvendësuar praktikën profesionale duhen adaptuar që të përmbushin të gjitha kërkesat ligjore për praktikatat.

Rekomandim: *Rekomandohet që praktika pozitive e internshipeve, që preferohej nga studentët, të standardizohet dhe të plotësojë më mirë kërkesat ligjore të praktikave profesionale.*

Sandardet përmbushen

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Nga analiza e RVB-së, dokumentave plotësues të vëna në dispozicion nga institucioni si dhe nga takimi me stafin drejtues dhe pedagogët ishte e qartë se institucioni i jepte një vëmendje të veçantë kërkimit shkencor cilësor dhe botimeve në medime serioze dhe prestigjioze akademike. Gjithashtu, institucioni bënte përpjekje maksimale që të lidhte në mënyrë organike kërkimin shkencor dhe ekspertizën kërkimore me mësim-dhënien në programin e studimit nën akreditim. Institucioni gjithashtu ka mekanizma për të kontrolluar, promovuar si dhe shpërblyer punën kërkimore të stafit si instrument për përmirësimin e punës dhe rritjen e standardeve kërkimore.

Nga analiza e dokumentacionit u vu re që në fakultetin ku ndodhet departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare strehohet edhe Qendra e Studimeve Evropiane (QSE) që është një qendër multi-disiplinore kërkimi me qëllim përmirësimin e kuptimit të çështjeve globale dhe të studimeve ndër-disiplinore. Qendra synon të organizojë sipërmarrje kërkimore, konferenca dhe aktivitete të ndryshme kërkimore për të siguruar një bashkë-veprim të stafit, studentëve dhe kërkuesve të interesuar për qendrën, në lidhje me studimet mbi Bashkimin Evropian. Qendra gjithashtu ndihmon në planifikimin dhe organizimin e kërkimeve dhe eventeve që kanë efekt edhe mbi këtë program studimit.

Gjithashtu, dhe po aq a rëndësishme, universiteti inkurajon anëtarët e stafit akademik të jenë aktivë në kërkim shkencor duke dhënë mbështetje financiare për procesin kërkimor të finalizuar me një produkt

kërkimor. Specifikisht, në fund të çdo viti akademik, botimet shkencore të stafit vlerësohen nga një juri në bazë të kriterëve të vendosura në rregulloren e universitetit “Për Promovimin e Botimeve Shkencore.” Rektorati vendos sasinë e shpërblimit për çdo pikë të fituar dhe në bazë të pikëve të mbledhura çdo anëtar i stafit akademik që plotëson kushtet merr shpërblimin përkatës. Universiteti ofron gjithashtu mbështetje dhe për pjesëmarrjen e stafit akademik në konferenca dhe aktivitete shkencore, të organizuara brenda dhe jashtë vendit, sipas të njëjtës rregullore.

Në përgjithësi mund të thuhet se kërkimi shkencor në Universitetin Epoka dhe departamentin që ofron programin objekt vlerësimi në kuadër të akreditit ishte një prioritet i cili merrte një mbështetje të konsiderueshme dhe të lavdërueshme.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për kërkimin shkencor (Tabelat ne aneks)

Kërkimi shkencor në institucion është normuar nëpërmjet një sërë rregullash dhe mekanizmash që sigurojnë cilësinë e produktit shkencor dhe i mundësojnë stafit që të ketë kohën dhe mjetet e nevojshme për të ndërmarr kërkim shkencor. Specifikisht, institucioni ka rregulloren për kërkimin shkencor që rregullon organizimin e veprimtarive të kërkimit shkencor, të drejtat dhe detyrimet e autoriteteve përkatëse të universitetit, të studiuesve dhe aktivitetet që kryhen për botimin nga ana e institucionit.

Nga pikpamja institucionale, aktivitetet kërkimore në qendra mbikqyren nga qendrat kërkimore përkatëse në përputhje me rregulloret e tyre dhe menaxhohen nga përgjegjësit e qendrave kërkimore. Ndërsa, mbështetja për financimin e projekteve të kërkimit bëhet në bashkëpunim me Zyrën e Kërkimit dhe Projekteve dhe Zyrën e Financës në universitet nën mbikëqyrjen e Rektorit dhe Sekretarit të Përgjithshëm.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disipinën përkatëse;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.</p>	<p>Nga tabelat e RVB-së mbi kërkimin shkencor ishte e qartë se stafi akademik i departamentit që ofron programin kishte qene tepër aktiv dhe i suksesshëm në botimet akademike. Stafi kishte marrë pjesë në shumë konferenca ndërkombëtare dhe kishte botuar artikuj shkencorë, monografi dhe kapituj në libra të edituar.</p>

	Gjithashtu, duke parë disa nga mediumet në të cilat ishin bërë disa publikime (të rankuara nga Thomson Reuters) është e qartë se botimet kanë cilësi të lartë dhe kontribuojnë në avancimin e dijes njerëzore dhe depërtimin e shkencës shqiptare në nivel ndërkombëtar.
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.</p>	<p>I gjithë procesi mësimor tek Universiteti Epoka në të gjitha nivelet e studimit zhvillohet në gjuhën angleze. Stafit akademik që ofron mësim-dhënie ka kryer të paktën një cikël studimesh në gjuhën angleze dhe pjesa dërrmuese kishin kryer studimet doktorale në gjuhën angleze. Një pjesë e stafit ishin të huaj kështu që një pjesë e takimeve u zhvillua në gjuhën angleze. Nga bashkëbisedimi u vu re qartë që niveli i anglishtes, nga pikpamja linguistike dhe akademike, ishte i një niveli të lartë.</p> <p>Personeli akademik i përfshirë në mësimdhënie kishte eksperiencë të gjatë në profesion dhe e kalonte limitin e një semestri.</p>
Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtjshëm të personelit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtjshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtjshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	<p>Nga takimi në institucion por edhe nga raportimi në RVB u informuam që dy herë në vit zhvilloheshin trajnime në rang universiteti për mësim-dhënie dhe kërkimin shkencor. Trajnimet, në varësi të mundësive, zhvilloheshin nga lektorë të huaj të ftuar specifikisht ose staf me eksperiencë i universitetit në nivel peer-to-peer. Përfundimet e trajnimeve, në formën e 'minutes' apo arritjesh, publikohen edhe online.</p> <p>Gjithashtu, gjatë takimit na u bë e ditur që cdo staf akademik ka në dispozicion, për cdo vit akademik, 750 Euro të cilat mund t'i përdorë për të marrë pjesë në aktivitete akademike apo aktivitete trajnuese dhe zhvilluese të mëtjshme brenda dhe jashtë vendit. Gjithashtu, në raste specifike, dhe me aprovim nga sekretari i përgjithshëm, stafit mund t'i rimbursohen shpenzimet nga pjesëmarrja në aktivitete kualifikuese.</p>
Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.	
Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të	Në fund të çdo viti akademik të gjithë anëtarët e stafit kanë detyrim të raportojnë të

<p>angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>	<p>gjithë aktivitetin dhe produktin e tyre kërkimor i cili përmbledhet dhe përpunohet në database në nivel universiteti. Bashkë me studimet shkencore institucioni disponon një bazë të plotë të dhënash mbi botimet. Të dhënat specifike për departamentin janë vënë në dispozicion në tabelat 36, 37, dhe 38 në RVB</p> <p>Gjithashtu institucioni disponon një bazë të të dhënave për projektet që kanë aplikuar dhe fituar anëtarët e stafit. Specifikisht për anëtarët e stafit të departamentit të ShPMN u vunë në dispozicion nëpërmjet RVB-së në faqet 127-134 dhe në tabelën 39.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Institucioni dhe departamenti kanë një strategji të qartë për kërkimin shkencor dhe outputet e pritshme nga kërkimi shkencor që aplikohet nga stafi akademik. 2. Institucioni mbështet anëtarët e stafit për të ndërmarrë kërkim shkencor nëpërmjet infrastrukturës së kampusit universitar dhe duke i dhënë akses falas në database të punimeve shkencore si JSTOR. Institucioni ofron gjithashtu mbështetje financiare për të marrë pjesë në aktivitete shkencore si dhe shpërblim financiar për botime shkencore më nivel të lartë. 3. Anëtarët e departamentit janë aktiv në kërkim shkencor nëpërmjet pjesëmarrjes në konferenca dhe botimeve të artikujve shkencorë në medime të rankuara nga Clarivate Analytics (ish Thomson Reuters) <p>Rekomendim: <i>Rekomendohet që të bëhet një punë më e mirë për promovimin e produktit shkencor të Epoka dhe të departamentit në veçanti jashtë universitetit si instrument për rritjen e vizibilitetit të universitetit dhe si një platformë për të ndërtuar ura bashkëpunimi me institucione të tjera akademike në Shqipëri.</i></p> <p>Standardet përmbushen</p>	

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Institucioni ka zhvilluar ndër vite një vizion i cili është prirur drejt bashkëpunimit ndërkombëtar, si në nivelin universitar ashtu edhe në atë të mobilitetit të studenteve dhe pedagogëve. Ndonese ka një prirje të theksuar për të zhvilluar këto mobilitete me disa universitete specifike (low hanging fruits), perseri ky mund të konsiderohet si një hap i parë në drejtim të zhvillimit të metejshëm të këtij bashkëpunimi

edhe me universitete te tjera. Eshte me rendesi te theksohet se universiteti ka zhvilluar strukturat, sic eshte Zyra e Marrredhenieve Nderkombetare apo zyra e Projekteve Nderkombetare, te cilat kane kontribuar jo vetem ne rritjen e aktiveteteve nderkombetare por edhe ne rritjen e nivelit te eksperiences per te permiresuar si nga ana sasiore ashtu edhe cilesore kete bashkepunim ne te ardhmen.

Ne vijim citojme disa nga funksionet kryesore te Zyrës së Marrëdhënieve Ndërkombëtare (ZMN), e cila perpiqet të krijojë kushtet e nevojshme për promovimin dhe intensifikimin e ndërkombëtarizimit të IAL.

- “mbështetje me marrëveshje bashkëpunimi ndërkombëtar (me hartim dhe negocim marrëveshjes, monitorim të zbatimit të marrëveshjeve ndërkombëtare).
- promovon përhapjen e informacionit te studentët dhe fakulteti për mundësi të ndryshme globale, si stazhet ndërkombëtare, programet e përbashkëta të diplomimit, bursat ndërkombëtare dhe aktivitetet shkencore dhe kulturore jashtë shtetit.
- asiston Zyrën e Koordinimit të Projekteve dhe Këshillimit në eksplorimin, vlerësimin dhe zbatimin e projekteve kërkimore me financim të jashtëm apo të sponsorizuar në Universitetin “Epoka”.
- organizon edhe aktivitete Internationalisation@Home që synojnë të zgjerojnë perspektivën globale të studentëve tanë, duke i ekspozuar ndaj kulturave të ndryshme në kampus”.

Institucioni merr pjese ne disa projekte nderkombetare sic jane Erasmus+ cka eshte nje mundesi e mire per te zhvilluar me tej bashkepunimin me universitetet perendimore. Eshte e rendesishme te theksohet se programi ne fjale ka nje Joint Degree me Leeds Beckett University ne Britanine e Madhe, cka eshte jo vetem nje burim experience per bashkepunime te tjera ne te ardhmen por edhe certifikimi i nje standarti te cilesise nga ane e ketij programi per te lidhur bashkepunime te tjera ne te ardhmen. Megjithatë, mobiliteti i personelit akademik dhe sidomos studentëve lë akoma vend per permiresim sidomos në projekte ndërkombëtare siç janë Erasmus+ të cilat ndihmojnë për të rritur angazhimin dhe bashkëpunimin me partnerë akademikë ndërkombëtarë. Për momentin pjesëmarrja në programe ndërkombëtare është relativisht e kenaqshme duke konsideruar moshen e programit, por informacioni i ofruar dhe informacioni i dhene nga pergjegjesja e zyres se projekteve nderkombetare, gjate vizites ne institucion, paraqet një strategji të qartë për të spjeguar se si mund të kapërcehe keto vështirësi.

Universiteti por edhe programi i marre ne shqyrtim kane lidhje te mira me komunitetin (pjese kjo edhe e strategjise se zhvillimit 2012-2017) por edhe me partnere nga fusha e biznesit dhe ajo institucionale. Megjithatë lidhjet me tregun e punës nepermjet bashkepunimit me institucionet publike dhe ato te huaja për programin në fjalë duhet te zhvillohen me tej dhe ne kete aspekt institucioni ne pergjithesi dhe programi ne vecanti duhet te ndermarrin hapa konkrete. Kjo do te kontribuojte edhe për të lehtësuar punësimin e studentëve nëpërmjet kontakteve institucionale të zhvilluara më parë me sektorë strategjikë për punësimin e studentëve të kësaj dege.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar (Tabelat ne aneks)

Sic shihet edhe nga *tabela 45 ne RVB* bashkëpunimi kombëtar dhe ndërkombëtar është disa-planësh. Ndonese kemi një numer IAL me të cilët zhvillohet pjesa kryesore e bashkëpunimit ndërkombëtar, perseri kjo ndihmon në rritjen e eksperiencës së stafit, përmirësimin e strukturave të institucionit por edhe ndërgjegjësimin e studenteve dhe pedagogëve mbi nevojën e thellimit dhe rritjes së këtij bashkëpunimi në të ardhmen.

Bashkëpunimi përfshin si marrëveshjet kuader me universitete apo institucione për kryerjen e praktikave mesimore ashtu edhe pjesëmarrjen në projekte ndërkombëtare dhe programe mobiliteti për studentet dhe pedagogët.

Një punë më e mirë duhet të bëhet për balancimin e bashkëpunimit ndërmjet të gjithë partnerëve akademikë dhe jo-akademikë sidomos në vendet e Evropës perëndimore.

Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë (plotëso të dhënat ne aneks)

Ka një game të gjërë bashkëpunimi me institucione qendrore, lokale, kompani dhe aktore të fushës së biznesit dhe mbi të gjitha me universitete brenda dhe jashtë vendit. Në këtë mënyrë është siguruar arritja e praktikave mesimore, çka është një hap i rëndësishëm për punësimin e studenteve në të ardhmen. Kjo është ndoshta edhe një nga arsytet e një numri të lartë të punësuarish ndërmjet të diplomuarve të këtij programi (ndonese numri i vogël i studenteve aktual favorizon këtë përqindje të lartë dhe suksesi real do të shihet më qartë kur të rritet me tej numri i studenteve).

Megjithatë me shumë mund të bëhet për të fokusuar më mirë këtë bashkëpunimin në planin akademik duke filluar me projekte kërkimore për ta thelluar më tej në programe akademike dypaleshe sic është rasti i diplomës dypaleshe (joint-degree) me universitetin Leeds Beckett University në Britaninë e Madhe.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.	
Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;	Praktika profesionale nuk është një kusht për tu realizuar për studentët që studiojnë në programin Master i Shkencave në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare por duke iu referuar tabelave me sipër të këtij kapitulli, institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet dhe

<p>Kriteri 2 Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>inkurajon pjesëmarrjen e studentëve në aktivitetet e praktikave. Institucioni ka renditur nje sere institucionesh publike dhe private, kombetare dhe nderkombetare me te cilat mund te lidhe marreveshje specifike bashkepunimi per kryerjen e praktikave studentore prane tyre. Natyrisht qe rritja (sidomos e cilesise) se ketij bashkepunimi me institucioni me te profilizuar ne fushen e ketij programi mbetet nje sfide e vazhdueshme edhe per te ardhmen</p>
<p>Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Institucioni nxit bashkepunimin ndermjet personelit brenda institucionit duke stimuluar pjesmarrien e tyre ne projekte nderkombetare, duke krijuar grupe kerkimore inter-disiplinare si edhe duke financuar projekte te perbashketa ne fusha specifike te kerkimit apo edhe botimeve (kombetare dhe nderkombetare). Në informacionin e paraqitur si nëpërmjet dokumentacionit por edhe vizitës në institucion spjegohen se si ndahen detyrat brenda personelit të institucionit, ndërmjet stafit akademik por edhe atij ndihmës dhe administrativ (<i>dokumenti mbi organizimin e institucionit</i>). Realizimi i përgjegjësive të marra bëhet nëpërmjet analizave të vazhdueshme për të parë ecurinë e programit dhe marrë masa korrigjuese në rast se është e nevojshme. Një shkëmbim i vazhdueshëm i eksperiencës me qëllim organizimin e punës shihet si një mekanizëm për të nxitur ndërmjet kolegeve marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>
<p>Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të</p>	<p>Institucioni inkurajon marredhenie bashkepunimi midis stafit te tij me institucione homologe nderkombetare. Keshtu universiteti merr pjese ne disa programe Erasmus+, ka nje numer te larte te pjesmarries se stafit ne konferenca nderkombetare, si edhe ne publikime jashte vendit, por edhe inkurajon nepermjet fondeve perkatese vizitat e stafit ne aktivite nderkombetare. Te gjitha keto aktivitete ndihmojne ne rritjen e bashkepunimit me kolege dhe institucione nderkombetare (sic eshte rasti i joint degree me Leeds University). Ndonese praktika mesimore nuk eshte e detyruar, institucioni ka vendosur marredhenie bashkepunimi me nje sere institucionesh publike dhe private te cilat mund te ndihmoje studentet si ne kryerjen e nje stazhi ashtu edhe ne vendosjen kontakteve per nje punesim te mundshem ne te</p>

studimeve.	ardhmen prane ketyre institucioneve. Institucioni ndihmon dhe mbeshtet trainimin e metejshem profesional si nepermjet fondeve te caktuara per kete qellim ashtu edhe nepermjet aplikimet per projekte brenda buxhetit te institucionit.
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Bashkepunimi me institucionet publike/private dhe universitetet ne nivel kombetar dhe nderkombetar eshte aktiv dhe eshte institucionalizuar si nepermjet marreveshjeve dypaleshe por edhe nepermjet pjesmarrjes ne projekte te ndryshme nder te cilat edhe Erasmus+. 2. Institucioni ben nje pune te mire per te nxitur bashkepunimin ndermjet pedagoqeve si brenda institucionit ashtu edhe me partneret nderkombetare. <p>Rekomandim: <i>Ka nje tendence per te patur nje bashkepunim jo shume te ekuilibruar (lindje-perendim) sidomos ndermjet partnereve akademike dhe kjo sfide duhet te adresohet sa me pare per te bere te mundur nje bashkepunim me te gjere (dhe shkembim eksperience me te frytshem) me institucionet akademike.</i></p> <p>Standartet përmbushen</p>	

ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

- 1) Lidhur me rekomandimin per shoqërimin e prezantimit te pasqyrave financiare dhe burimeve e të ardhurave si dhe menaxhimi i tyre, me një analizë të hollësishme të shpenzimeve të shoqëruara me pranimet përkatëse, institucioni ka krijuar një zyrë të vecantë finance e cila në bashkëpunimin me kompaninë e cila ka në pronesi këtë univesitet menaxhon burimet financiare. Nga vizita në institucion u informuam që kompania mëmë e institucionit bën një analizë të hollësishme të shpenzimeve e cila më pas përdoret për formulimin e buxhetit të universitetit i cili është i pavarur dhe administrohet nga instancat e universitetit.

GVJ vlerëson se rekomandimi është përmbushur plotësisht.

- 2) Për rekomandimin mbi zgjerimin e bashkepunimit me institucionet homologe si ne lindje ashtu edhe ne perendim, institucioni ka ndermarre nje sere marreveshjesh bashkepunimi si bilaterale

ashtu edhe ne kuader te disa projekteve nderkombetare sic jane Erasmus + ku universiteti ben pjese. Keto krijojne jo vetem mundesi te mira shkembimi eksperience per stafin akademik por edhe rrisin mobilitetin nderkombetar te studenteve. Aktualisht ka shkembime pedagogesh kryesisht per leksione hapura por jo ne nivel me te strukturuar dhe afatgjate (sic do te ishte joint apo double-degree) Ka nje pjesmarrje te kenaqshme te Universitetit ne projektet e BE-se per mobilitetin e studenteve dhe te pedagoqeve, ndersa per keta te fundit universiteti mbulon edhe shpenzimet ne rast pjesmarrjeje ne takime nderkombetare apo prezantime te punes akademike.

GVJ vlerëson se rekomandimi është përmbushur plotësisht.


